



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1022/1 Prot.

Tiranë më 17.07.2018

Lënda: Relacion për Draft-Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës

SENATIT AKADEMIK

Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 10/07/2018, pasi shqyrtoi nen për nen draft – statutin e hartuar nga grupi i punës, vendosi ta miratojë atë me ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

KREUI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

➤ Neni 2

Lloji i institucionit, liria akademike dhe autonomia universitare

Pika 3, gërra c, në fund të fjalisë shtohet:por pa cënuar interesat institucionale dhe në respekt të Kodit të Etikës së UPT.

Liria akademike eshte e drejta qe ka pedagogu ta zhvilloje mesimdhienien dhe kerkimin shkencor i pandikuar nga askush (rektori, dekani apo qeveria). Liria akademike nuk mund ti shtrij kufijt e saj jashte “auditorit” ku jepet mesim apo ku behet kerkim shkencor. Jashte “auditorit” veprojne lirite dhe te drejtat themelore te njeriut qe mbrohen nga Kushtetua e RSh-s dhe nuk mund te afirmohen ne Statutin e institucionit. Lirite dhe te drejtat e çdo pedagogu apo personeli akademik ne raport me institucionin, vendimet dhe autoritet e tij drejtuese shtrihen deri ne kufijt e moscenimit te imazhit dhe reputacionit te organizates ku ben pjese. Askush nuk mund te demtoje organizaten per sa kohe eshte pjese e saj, por ne te kundert duhet te bej çdo perpjekje per te permiresuar reputacionin e organizates qe e ka punesuar.

➤ Neni 4

Pacënueshmëria e territorit

Në pikën 1 dhe pikën 3, fjalja “titullarit” zëvendësohet me “Administratorit të Institucionit”

Pika 1 dhe 3, parashikon që leja për ndërhyrjen në ambjentet e institucionit, jepet nga titullari duke mos përcaktuar se cili nga titullarët, administratori apo rektori. Në zbatim të nenit 31, pika 1 dhe nenin 51, pika 1 të ligjit për arsimin e lartë, Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, por jo për çështjet që lidhen me veprimtarinë administrative të institucionit. Këto Jane aspekte të veprimtarisë së përditshme administrative të institucionit, me një natyrë operative dhe larg asaj akademike të cilat i përkasin administratorit si autoritetit më të lartë për çështjet administrative dhe financiare.

Bordi i Administrimit vlereson se titullari ne kuptim te dispozites ne fjale, eshte administratori i institucionit sepse eshte detyre e tij funksionale te ruaje dhe mireadministroje asetet, perfshi ketu godinat ku zhvillohet veprimtaria e institucionit, nga demtimet, aktet vandale, nderhyrjet e paautorizuara dhe cdo lloj aktiviteti te paligjshem.

K R E U II

STRUKTURA AKADEMIKE E UPT

» Neni 5

Njësitë përbërëse të Universitetit Politeknik të Tiranës

Riformulohet si më poshtë vijon:

I. Brenda UPT funksionojnë :

- njësitë kryesore, që janë fakulteti dhe instituti i kërkimit dhe zhvillimit;
- njësitë bazë, që janë departamenti dhe gendra e kërkimit;
- degët, që mund të janë njësi kryesore ose njësi bazë;
- njësitë ndihmëse, janë strukturat mbeshtetese te percaktuara ne strukturen e UPT, te cilat ndihmojnë institucionin, njesite kryesore dhe njesite baze ne realizimin e veprimtarise mesimdhene, kerkimore shkencore dhe ate administrative.
- Shoqëritë tregtare dhe organizatat joftimprurëse me themelues Universitetin Politeknik të Tiranës.

Njësitë kryesore, njësitë bazë, degët, njësitë ndihmëse shoqëritë tregtare dhe organizatat joftimprurëse krijojen, mbyllen, organizohen dhe riorganizohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe këtë statut, si pjesë e organogramës së UPT, me vendimarrje individuale.

Njesite ndihmese, nuk eshte e nevojshme te jene te cituara ne statut, pasi ashtu si njesite kryesore dhe njesite baze, mund te ndryshojne ne varesi te nevojave te institucionit dhe ndryshimi i tyre do te kerkajo ndryshime te shpeshta te statutit, i cili eshte akti themelor i institucionit. Njesite ndihmese percaktohen ne aktet e brendshme te institucionit, ndersa ne statut percaktohet perkufizimi i per gjithshem i tyre.

Ne kete dispozite Bordi i Administrimit vleresoit te nevojshem parashikimin ne statut te krijmit e strukturave te tjera te organizuara ne formen e shoqerive tregtare dhe organizatave

jofitimprurese, si një mundesi per institucionin, per te zgjeruar aktivitetin e tij, me qellim realizimin e misionit te tij dhe rritjen e prezencences dhe performances se tij, ne kushtet e konkurrences se tregut.

- Pas nenit 6. të shtohen dy dispozita “Shoqëritë tregtare të Universitetit Politeknik të Tiranës” dhe “Organizatat jofitimprurëse të Universitetit Politeknik të Tiranës” si më poshtë:

Shoqëritë tregtare të Universitetit Politeknik të Tiranës

1. Universiteti Politeknik i Tiranës me qëllim përdorimin e rezultateve, njohurive, të kërkimit shkencor ka të drejtë që të krijojë shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
2. Shoqëritë tregtare që krijohen për këtë qëllim përdoren për realizimin e një aktiviteti biznesi me karakter inovativ, mbështetur në rezultatet e kërkimit shkencor të zhvilluar në kuadër të programeve universitare.
3. Krijimi i këtyre shoqërive tregtare propozohet nga Senati bazuar ne planbiznesin e paragitur nga Administratori i Institucionit dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.
4. Bordi i Administrimit shqyrton dhe vendos, në lidhje me formën e shoqërisë tregtare, vlerën dhe formën e kapitalit që do të përdoret për krijimin e saj, mënyrën e administrimit, strukturën e saj, mënyrën e raportimit etj.
5. Senati Akademik, shqyrton dhe vendos në lidhje me fushën e veprimtarisë, kalimin e të drejtave të përdorimit dhe gjëzimit të patentave, njohurive, shpikjeve etj., të cilat do të përdoren nga shoqëria tregtare.
6. Këto shoqëri tregtare mund të krijohen nga Universiteti Politeknik i Tiranës në mënyrë ekskluzive ose në bashkëpunim me persona juridikë të tjera. Në këtë rast nga Bordi i Administrimit miratohet edhe marrëveshja për mënyrën e ndarjes së kuotave/aksioneve që do të kenë palët në këtë shoqëri.
7. Statuti i shoqërise miratohet nga Bordi i Administrimit.

Organizatat jofitimprurëse të Universitetit Politeknik të Tiranës

Në Universitetin Politeknik i Tiranës me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e vlerave dhe traditave kulturore dhe historike, shkencës dhe arsimit, edukimit fizik dhe shpirtëror, si dhe për çdo drejtim tjetër në të mirë të studentëve, mund të krijojë Organizata Jofitimprurëse, në formën e shogatave, fondacioneve apo qendrave.

Veprimtaria e tyre do të rregullohet në bazë të legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor si dhe ligjit për Organizatat Jofitimprurese.

Krijimi i Organizatave Jofitimprurëse dhe fusha e veprimtarisë së tyre propozohet nga Senati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit.

KREU III

**ORGANET KOLEGJIALE, AUTORITETET DREJTUESE DHE ADMINISTRATIVE
TË UPT**

➤ Neni 7

Senati Akademik

Pika 1, riformulohet në përputhje me nenin 37, pika 1 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si më poshtë:

“Senati është organi kolegjial më i lartë akademik i UPT, përgjegjës për përbushjen e misionit të tij.”

Pika 5, fjalia e fundit riformulohet si më poshtë:

“Numri i anëtarëve të Senatit Akademik është tek. Në rast se gjatë votimit numri i votave është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, atëherë vota e Rektorit është vendimtare. Në çdo rast tjeter bëhet rivotim”.

Për sa i përket numrit të anëtarëve të Senatit të UPT, ai është gjithmon tek, dhe ky fakt është një parim themelor për përbërjen dhe funksionimin e të gjitha organeve kolegiale, ndersa per mënyrën e votimit i referohemi ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

➤ Neni 8

Bordi i Administrimit

Në pikën 2, referuar nenit 49 pika 4 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se: “Funksione të tjera të Bordit të Administrimit, përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë”, Bordi Administrimit vlereson se per realizimin e misionit te vete, eshte e nevojshme të shtohen funksionet e më poshtme:

- l) Miraton kartën e auditit financiar të UPT, planin strategik dhe vjetor si edhe programet e angazhimit;
- m) Siguron që Administratori të informohet me raportet vjetore të auditimit të brendshëm të njësisë për mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim marrjen e masave përmirësimin e tij dhe hartimit të deklaratës vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- n) Ngre komisione e grupe pune për çështje dhe veprimtari të veçanta, brenda kopetencave te tij;
- nj) Miraton shpërblimin e anëtarëve të komisioneve të përhershme apo të përkohshme, anëtarëve të Senatit dhe Bordit, pas propozimit te Administratorit dhe miratimit nga Senati, si dhe trajtimin e veçantë financiar për personelin akademik, personelin ndihmës-akademik dhe administrativ të

vlerësuar shumë mirë;

- o) Përcakton fondet për realizimin e projekteve të ndryshme kërkimore- shkencore;
- p)Percakton fondet për mbështetjen financiare për organizatat joftimprurëse që krijohen në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Pika 4 riformulohet si më poshtë vijon:

"Rektori i UPT është i ftuar të marrë pjesë në mbledhjet e BAUPT pa të drejtë vote".

Bazuar në nenin 48, pika 6 të ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet se: "Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët nuk mund të janë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij", bëhet ndryshimi nga mund të marrë pjesë në është i ftuar të marrë pjesë.

Në pikën 6 në fund të fjalisë, referuar nenit 48, pika 6 të ligjit, vleresohet se eshte e domosdoshme të shtohet"pa të drejtë vote".

➤ Neni 9

Rektorati

Bordi i Administrimit vlereson se, pika 2 e nenit që përcakton numrin e zv/rektorëve duhet të hiqet. Numri i zëvendësrektoreve është pjesë e strukturës dhe në këtë rast nuk duhet të vendosen në statut pasi ato janë fleksibël dhe i takon organeve që ato ndihmojnë, të propozojnë për numrin e tyre. Zëvëndësrektorët janë funksione apo poste ndihmëse për Rektorin për të ushtruar funksionet e tij dhe në të ardhmen mund të nevojiten një ose më shumë se dy zv/rektorë. Duke u përcaktuar numri në statut, praktikisht i hiqet një kompetencë Senatit Akademik i cili sipas ligjit, propozon strukturën e UPT. Pra numri i zëvëndësrektoreve nuk duhet të përcaktohet në statut.

Pika 4, gërrma c ndryshon nga "përcakton" prioritetet për shpërndarjen e burimeve financiare në "propozon" prioritetet për shpërndarjen e burimeve financiare.

Parashikimi "përcakton" prioritetet, bie ndesh me nenin 52, pika 1, gërrma a dhe b e ligjt për arsimin e lartë ku përcaktohet se Administratori a) harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij, b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale.

Pika 8 riformulohet, "Detyra dhe funksione të tjera të Rektoratit përcaktohen në Rregulloren e Rektoratit të UPT", pasi detyrat dhe funksionimi i Rektoratit në mënyrë të detajuar përcaktohen në Rregulloren e Rektoratit, si organ kolegjial.

➤ Neni 10

Keshilli i Etikës

Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“Këshilli i Etikës ngrihet pranë UPT dhe promovon e shqyrt俊 cështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera, sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit në fuqi, për të gjithë personelin e UPT”.

Nëse në “veprimtari të tjera institucionale” përfshihen dhe veprimtari të tjera jashtë atyre të përcaktura të procesit mësimor dhe kërkimor, atehere edhe përbërja, organizimi dhe funksionimi i ketij organi duhet të ndryshojë.

Bordi i Administrimit vlereson se, duhet te kete një organ te vetem per te gjithe personelin e institucionit per te shqyrtuar ceshtjet qe lidhen me kodin e etikes. Keshilli i Etikës mund te marre ne shqyrtim jo vetem ceshtje akademike por edhe shkeljet e kodit te etikes nga personeli akademik, ndihmesakademik, administrative dhe studentet.

Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“Këshilli i Etikës i UPT përbëhet nga një përfaqësues për çdo njësi kryesore të tij, një përfaqësues nga personeli administrativ, një nga personeli ndihmës akademik dhe një përfaqësues i studentëve në SAUPT”.

Meqënëse propozohet që Këshilli i Etikës të marrë në shqyrtim jo vetëm çeshtje akademike por edhe shkeljet e kodit te etikes nga personeli akademik, ndihmesakademik, administrative dhe studentet, ne perberjen e tij duhet te kete anetare perfaqësues nga te gjitha kategorite e siper cituara .

Pika 3 ndryshon si më poshtë:

3. Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen nga SAUPT, mbi bazën e propozimeve të bëra nga njësitet kryesore, Administratori për anëtarët e stafit të personelit administrativ, Rektori për personlin ndihmës akademik dhe komuniteti i studentëve të UPT.

Pika 8 ndryshon si më poshtë vijon:

“Kodi i etikës miratohet nga SAUPT dhe BAUPT”.

Pika 9 në fund të fjalisë shtohet “dhe BAUPT”.

➤ Neni 11 dhe nenii 12

Neni 11 dhe nenii 12 bashkohen ne një dispozitë të vetme të titulluar “Dekanati/Drejtoria e Institututit të Kërkim- Zhvilit” me përbajtje si më poshtë:

1. Dekanati / Drejtoria e Institututit të Kërkim-Zhvillimit në UPT është organ kolegjal përbëhet nga:

- a) Dekani / Drejtori i Institututit të Kërkim-Zhvillimit;
b) Zëvendësdekanët / Zv. Drejtori / Zv. Drejtoret;
c) administratori i Fakultetit /administratori i Institututit të Kërkim-Zhvillimit;
d) drejtuesit e njësive bazë.
2. Dekanati/Drejtoria drejtohet nga Dekani / Drejtori i Institututit të Kërkim-Zhvillimit.
3. Numri i zv. dekanëve zv. Drejtoreve në fakultet/institut e UPT është së paku 2 (dy).
Zv.Dekanët / Zv. Drejtoret janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik të Fakultetit / Institutit.
4. Zëvendësdekanët/ Zv. Drejtoret përzgjidhen nga personeli akademik i njësisë kryesore respektive, të cilët kanë, sëpaku, gradën shkencore Doktor.
5. Dekanati / Drejtoria e Institututit të Kërkim-Zhvillimit ushtron këto funksione :
 - a) harton planin strategik të zhvillimit të Fakultetit / Institutit, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të administratorit të tij;
 - b) koordinon procesin e hartimit të buxhetit sipas kërkesave të njësive bazë dhe ja paraqet administratorit të saj;
 - c) shqyrton programet e reja të studimit, të propozuara nga njësitë bazë, për përputhshmérinë e tyre me standarde e cilësisë dhe i dërgon për miratim në SAUPT;
 - d) përcjell për miratim në SAUPT projektet e kërkimit shkencor të hartuara nga njësitë bazë, kur financimi kryhet nga UPT;
 - e) monitoron dhe koordinon veprimtarinë e njësive bazë;
 - f) harton rregulloren e fakultetit dhe ja përcjell Rektoratit për miratim Asamblesë së personelit akademik;
 - g) i paraqet Rektoratit strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet, mbështetur në propozimet e njësive bazë;
 - h) shpall projektet fituese për t'u financuar nga fondet për kërkim shkencor nga të ardhurat e fakultetit / institutit, si dhe bursat për studime shkencore, që administrohen nga vetë fakulteti / instituti;
 - i) miraton kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve, të cilat përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit;
 - j) miraton kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë, të cilat përcaktohen nga njësitë bazë, në përputhje me standarde e cilësisë;
 - k) miraton listën e periodikëve shkencorë, ku do të pajtohet fakulteti/instituti, si dhe titujt e librave që do të blihen nga biblioteka;
 - l) ushtron edhe funksione të tjera, që përcaktohen në rregulloren e UPT, bazuar në specifikën e secilit fakultet / institutit.
6. Në ushtrimin e funksioneve të tij Dekanati / Drejtoria shprehet me vendime.

➤ Neni 13

Asambleja e Personelit Akademik

Në pikën 2 të nenit 13, fjala “të njësisë” kryesore ndryshohet me “të njësive” kryesore.

➤ Neni 14

Komisioni i Promovimit të Titujve Akademik në UPT

Pika 1 e nenit, riformulohet si më poshtë:

"Komisioni i përhershëm i Promovimit të Titujve Akademikë (KPTA) në UPT ka në përbërjen e tij 7 (shtatë) anëtarë".

Lidhur me këtë komision, propozohet përbërja e tij me 7 anëtarë. Kjo është e lidhur jo vetem me efektin finansiar por edhe me faktin që një komision duhet te jete ne raport te drejte me te gjithe organet kolegiale te UPT-s.

Komisioni eshte organ kolegjal vendimarrues dhe jo nje organ ekspertesh. Sigurisht qe ne komision do ishte e udhes qe te zgjidheshin personalitetet me te shquara akademike te UPT-s, por roli i tyre nuk eshte shqyrtimi teknik i cdo kerkese per titull. Komisioni ka te drejte te caktoje eksperte te fushes qe pergatisin relacionet perkatese e mbi bazen e tyre komisioni vlereson dhe vendos marrjen ose jo ne konsiderate.

Per kete arsyen nuk eshte aspak e nevojshme qe komisioni te zgjerohet duke pasur si argument mbulimin e fushave. Asnjehher numri i komisionit nuk do jete ne perputhje me larmine e programeve qe ofron UPT-s.

Kjo zgjidhje shhang edhe konfliktin e interesit. Vendimarrja e bordit per kete pike eshte zgjedhja e 7 (shtatë) anëtarëve, nga lista e te vetekandiduarve, të papërcaktuar nga cila njësi vijnë.

Kjo zgjidhje nuk merr ne konsiderate gjithashtu edhe propozimin e grupit te punes që Rektori, të jetë automatikisht anëtar i komisionit. Ligji e përcakton qartë në nenin 46, pika 3, që anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit të arsimit të lartë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ky është organ i zgjedhur dhe asnjë anëtar i komisionit nuk mund të jetë pjesë e komisioneve ex officio, përfshi këtu edhe kryetarin pasi bie në kundërshtim me ligjin.

Qellimi i ligjit eshte te mos perjashtohen automatikisht autoritetet drejtuese per shkak te detyres por ti nenshtrohen perseri porcesit zgjedhor njesoj si anetaret e tjere.

➤ Neni 17

Rektori

Në pikën 9, fjala "të përcaktuara" nga njësia bazë ndryshohet me "pasi përcaktohen" nga njësia bazë.

Në pikën 9, gërmë f, përpëra SAUPT, BAUPT dhe Këshilli i i Etikës, shtohet "organet"

Pika 9, gërmë h) "emëron drejtorët e drejtorive dhe specialistët në Rektorat, të cilët janë personel

akademik ose ndihmës akademik, duke iu përbajtur kriterieve të punësimit të miratuara nga instancat përkatëse”, hiqet.

Bordi i Administrimit vlereson se personeli akademik i angazhuar në Rektorat, nuk duhet të jetë njëkohësisht edhe personel administrativ apo ndihmës akademike me karakter administrativ. Drejtoritë në Rektorat qe trajtojne ceshjtjet me natyre akademike, kryejnë funksione të pastra administrative dhe ndihmojnë Rektorin të ushtrojë funksionet e tij. Një personel akademik mund të emërohet në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë por duhet të ushtrojë funksionin e personelit akademik vetëm me kohë të pjesshme. Pra ai nuk mund të ushtrojë funksionin e drejtorit 8 orë në ditë dhe njëkohësisht të jetë personel akademik me kohë të plotë. Kjo praktike duhet te marre fund ne UPT, per ti dhene një drejtim efikas dhe modern administrates.

Një punonjes nuk mund të ushtrojë dy funksione me kohë të plotë në të njëjtën kohë. Kjo bie dhe në kundërshtim me ligjin nen 64 i cili përcakton qartë ndalimin e dypunësimit të personelit akademik.

Kjo është shkelje e çdo lloj praktike të punësimit në një organizatë. Duke e angazhuar personelin akademik njëkohësisht si drejtor, ai merr përgjegjësinë të bëj një pune me kohë të plotë si në pozicionin e Drejtorit si dhe përgjegjësinë për të bërë po një punë me kohë të plotë si personel akademik, duke mos pasur eficencen per te cilën eshte kontraktuar nga njera anë dhe nga ana tjeter duke bllokuar në këtë mënyrë edhe pozicionin administrativ edhe pozicionin e personelit akademik, nga prurjet e reja. Kjo praktike e ndjekur deri tanë provon ne vetevete faktin se njera prej detyrave qe ushtron ne dypunesim individi eshte e panevojshme pasi ka nevoje per gjysmen e kohes se angazhimit te nje personi ne pune.

Personeli akademik i angazhuar, jep çdo lloj ndihme në procesin e punës së Rektorit apo grupet e punës qe ai ngrë, por nuk mund te bëj një punë me kohë të plotë si personel ndihmës akademike me karakter administrativ pasi keto jane dy kategori dhe pozicione te ndryshme. Gjithashtu referuar pikës 16 të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” përcaktohet qartë se personeli akademik me kohë të plotë, nuk mund të ushtrojë asnjë pozicion administrativ me kohë të plotë.

Nëse caktohet një personel akademik në pozicionin e drejtorit në Rektorat, ai mund të paguhet për punën e drejtorit dhe njëkohësisht të marrë shtesën e gradës apo titullit që mban.

➤ Neni 18 dhe nen 19

Neni 18 dhe nen 19 bashkohen në një dispozitë të vetme të titulluar “Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT” me përbajtje si më poshtë:

1. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT është Dekani i FAUPT ose Drejtori i Institutit të Kërkim Zhvillimit
2. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore të UPT dhe përfaqësuesi i tij.
3. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

tij.

15. Mandati i drejtuesit të njësisë kryesore zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Pas perfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
16. Mandati i drejtuesit të njësisë kryesore mbaron kur:
 - a) përfundon afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - c) e shkeljeve të rënda të ligjit sipas përcaktimeve në kornizën ligjore në fuqi.
17. Në rastet e krijimit të një njësie të re kryesore në UPT, drejtuesi i saj emërohet nga Rektori për një mandat me kohëzgjatje njëvjeçare, me detyrë organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të drejtuesi të asaj njësie kryesore dhe njësive përbërëse, brenda kohëzgjatjes së mandatit.

➤ Neni 20

Drejtuesi i njësisë bazë

Pika 7, në fund të fjalisë shtohet “brenda kompetencave të tij”.

➤ Neni 21

Administratori i UPT

Pika 8 pas gërmës I, në mbështetje të nenit 52 pika 2 ku përcaktohet se: “Funksione të tjera të administratorit përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, i ndryshuar, ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financier dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, per permbyshjen e detyrave dhe perqejjesive te tij, eshte e nevojshme, shtohen dhe funksionet e mëposhtme:

- drejton procedurat e rekrutimit të personelit administrativ dhe personelit të shërbimit sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe procedurave të miratuara nga Bordi i Administrimit;
- përfaqëson institucionin përpara institucioneve shtetërore, apo subjekteve të tjera përcështje administrative dhe financiare; Nënshkruan dokumentet e hartuara me karakter administrativ dhe financier, që dalin në emër të UPT-së;
- mbikëqyr zhatimin e ligishmërisë në veprimtarinë e institucionit;

- kontrollon zbatimin e rregullave të etikës nga administrata dhe merr masat e duhura disiplinore ndaj shkeljeve të konstatuara nga Këshilli i Etikës së UPT;
- i paragjet për miratim Bordit të Administrimit, rregulloren e brendshme, strukturën dhe kriteret e emërimit të personelit administrativ;
- emëron dhe shkarkon personelin administrativ të UPT në përputhje me legjisacionin në fuqi;
- miraton planet vjetore të punës së njësive në varësi të tij strukturore e funksionale dhe kontrollon realizimin e tyre.
- në bashkëpunim me strukturat akademike dhe administrative të universitetit, harton dhe ndjek realizimin e një plani afatmesëm/afatgjatë me detyra të sakta e me afate kohore, për gjenerimin e të ardhurave alternative, duke synuar rritjen graduale pavarësisë financiare, përmes rritjes së përqindjes së të ardhurave të universitetit në totalin e buxhetit të tij.
- propozon në Bordin e Administrimit ndryshimin e destinacionit të fondeve nga një njësi shpenzuese në një tjeter;
- shqyrton kërkesat dhe miraton rishpërndarjet brenda të njëjtit artikull buxhetor të shpenzimeve korrente, pa tejkaluar limitet buxhetore të miratuara nga Bordi i Administrimit;
- ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e Titularit të Autoritetit Kontraktor - Universiteti i Politeknik i Tiranës, bazuar në legjisacionin në fuqi për prokurimet publike;
- administratori mund të delegojë një ose disa nga kompetencat e tij tek autoritet apo strukturat vartëse, sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurave Administrativ në RSH-së;
- nxjerr urdhra dhe vendime në funksion të drejtimit të veprimtarisë administrative e financiare te institucionit.

➤ Neni 22

Administratori i njësisë kryesore në UPT

Pika 1 riformulohet duke cituar dhe përcaktimin ligjor të sanksionuar në nenin 36, pika 4 të ligjit për arsimin e lartë si më poshtë:

“Administratori i njësisë kryesore eshte autoriteti më i lartë administrativ përgjegjës për mirëfunkcionimin financiar dhe administrativ të saj”.

Në pikën 7 pas gërmës h, në përbushje të përgjegjësive që ka administratori i njësisë kryesore për çështjet administrative, shtohet gëрма “i” me përbajtjen si mëposhtë:

“Mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e njësisë kryesore”.

KREU IV

PRONAT, FINANCIMI DHE SHËRBIMET NË UPT

➤ Neni 31

Auditimi i brendshëm

Riformulohet në përputhje me legjislacionin për auditimin e brendshëm si më poshtë:

1. Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim përmenaxhimin, e projektuar përmes një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike përshtuar vlerë e përpërmirësuar veprimtarinë e Universitetit Politeknik të Tiranës.
2. Nësia e auditimit të brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës ka varësi organizative dhe funksionale tek Bordi i Administrimit dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi i Administrimit. BAUPT mund të kërkojë auditime të brendshme shtesë.
3. Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Brendshëm të Universitetit Politeknik të Tiranës, e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.

KREU V

PERSONELI UPT

➤ Neni 43

Punësimi i personelit ndihmës-akademik

Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit “ad-hoc”, si edhe të përzgjedhjes së personelit ndihmës-akademik janë në përputhje me përcaktimet e bëra në Rregulloren e punësimit të personelit ndihmës-akademik”.

Neni 47

Pika 4 riformulohet si më poshtë:

"Procedurat për përzgjedhjen e kandidatit fitues i referohen procedurave të punësimit të miratuara nga BAUPT".

K R E U VII

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË UPT

➤ Neni 62

Pranimet në programet e studimit të UPT

Në pikën 1 fjalia dytë "UPT" ndryshohet me "njësia bazë përgjegjëse"

Në zbatim të ligjit, çdo IAL vendos kritere pranimi të cilat propozohen nga njësia bazë.

K R Y E T A R I



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelimi i institucionit

1. Universiteti Politeknik i Tiranës u themelua në vitin 1951, me emërtimin **Instituti i Lartë Politeknik**. Në vitin 1957 e tërë struktura e tij u integrua në Universitetin Shtetëror Tiranës. Në vitin 1991 u rithemelua **Universiteti Politeknik i Tiranës**, i shkëputur nga Universiteti i Tiranës duke rigrupuar në strukturën e tij akademike të gjitha fakultetet me formim inxhinierik, i riorganizuar si universitet publik më vete.
2. Akronimi zyrtar i Universitetit Politeknik të Tiranës është UPT.
3. UPT ka stemën institucionale të depozituar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe ajo figuron në të gjithë dokumentet zyrtare të emetuar prej tij.

Neni 2

Lloji i institucionit, liria akademike dhe autonomia universitare

1. Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë i llojit universitet në përputhje me përcaktimet e kornizës ligjore në fuqi, i pavarur nga çdo orientim fetar, ideologjik dhe politik.
2. Universiteti Politeknik i Tiranës ka statusin e personit juridik publik, e ka selinë në sheshin “Nënë Tereza”, nr. 1, 1010 Tiranë dhe mund të konstituojë degë të tij në Shqipëri dhe jashtë territorit të saj.
3. Liria akademike është nocion universal, që i jep personelit akademik të UPT:
 - a) të drejtën për të zhvilluar mësimdhënie, për të kryer kërkim apo krijim pa pasur detyrimin e aderimit në ndonjë doktrine politike ose fetare të paravendosur;
 - b) të drejtën për të publikuar dhe përhapur kontributet dhe rezultatet e mësimdhënies, kërkimit apo krijimit;
 - c) të drejtën e shprehjes së mendimit, duke përfshirë kritikën ndaj shoqërisë, institucioneve, doktrinave, dogmave e opinioneve si edhe ndaj statutit dhe rregulloreve të UPT si edhe ndaj politikave qeveritare të arsimit të lartë e kërkimit shkencor, por pa cënuar interesat institucionale dhe në respekt të kodit të etikës së UPT.
 - d) garancinë dhe të drejtën për të zhvilluar veprimtarinë e tij pa qenë subjekt i presionit ose censurës pavarësisht nga orientimi i të menduarit e tyre, nga mënyra e jetesës, nga përkatësia etnike, gjuha, gjinia, orientimi seksual, aftësia e kufizuar e veprimtarive fizike, mendimi politik ose fetar, mosha dhe gjendja martesore.





Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

4. Autonomia universitare është nocion universal, aftësi e institucioneve të arsimit të lartë, në përgjithësi dhe i UPT në mënyrë të veçantë, për tu vetëmenaxhuar, përshtatur dhe ripërtërtur në ruajtje të vlerave thelbësore të dijes, kërkimit dhe krijimit duke siguruar përbushjen e misionit të tij, pa ndërhyrje të panevojshme nga qeveria, korporatat, policia dhe grupet e interesit si edhe pa asnjë ndërhyrje nga institucionet fetare.
5. Universiteti Politeknik i Tiranës garanton lirinë akademike dhe ka autonomi universitare në përputhje me kornizën ligjore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Misioni dhe objektivat institucionalë

1. Misioni i UPT është:
 - a) të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
 - b) të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës në fushat e tij të ekspertizës;
 - c) të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
 - ç) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.
2. Veprimtaria akademike e UPT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standarde e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës.
3. UPT është institucion i arsimit të lartë, qëllimi kryesor i të cilit është përparimi i shkencës, i teknologjisë dhe arsimit të lartë nëpërmjet integrimit të tyre. UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin.
4. UPT promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar; ai siguron koordinimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. UPT nxit përftimin e njohurive më të përparuara shkencore dhe teknologjike dhe i jep vlerë ekspertizës dhe aftësive kërkimore të tij në fusha të ndryshme të shkencës dhe kërkimit.
5. UPT ofron të gjitha nivelet e arsimit të lartë, që i korrespondojnë niveleve 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve; ai përcakton karakteristikat dhe përbajtjen e programeve të studimit. UPT nxit konsolidimin dhe përparimin e sistemit formues-edukativ përmes modeleve tradicionalë dhe atyre të rinj bashkëkohorë. UPT përcakton, zhvillon dhe konsolidon mënyrat e kontrollit të dijeve të studentëve sipas parimeve të meritës dhe paanshmërisë.
6. UPT mbështet dhe mbron studentët në ushtrimin e të drejtës së tyre për arsim cilësor dhe siguron përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e tij. UPT përpinqet në promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor, mendimit kritik, tolerancës politike dhe fetare,



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

barazisë gjinore, vlerave demokratike dhe qytetare, në mënyrë që të forcojnë qytetarinë Evropiane dhe globale të studentëve, të cilët do të hedhin themel për një shoqëri gjithëpërfshirëse.

7. UPT promovon inovacionin në mësimdhëne në një mjedis me qëndër studentin duke shfrytëzuar gjerësish potencialin e teknologjive të reja në mësimdhënie.
8. UPT ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve. Ai ofron shërbime me pikësynim integrimin optimal të të diplomuarve të tij në tregun e punës dhe ndërmerr nisma, që synojnë krijimin e vendeve të reja për punë të kualifikuar. Ruan lidhje kulturore, profesionale dhe personale me të diplomuarit e tij.
9. UPT garanton zhvillimin e karrierës të personelit akademik, në respekt të lirisë akademike, mëritës dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
10. UPT mundëson kualifikimin e vazdueshëm të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ.

Neni 4 Pacënueshmëria e territorit

1. Të gjitha mjediset, që shteti i ka lënë në administrim UPT dhe ku ai ushtron veprimtarinë e tij gjithnjë paprekshmérinë. Ndalohet ndërhyrja në mjediset e UPT e personave fizikë apo juridikë privatë e shtetërorë, të pushtetit qendror e lokal, si dhe ajo e organeve të rendit publik pa lejen apo kërkesën e Administratorit te institucionit.
2. Cënimi i kësaj paprekshmërie përbën shkelje ligjore ndaj UPT, të cilit i lind e drejta e denoncimit të saj, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Në rastin e kryerjes së një krimi flagrant kundër jetës ose të ndodhjes së një fatkeqësie natyrore, që konsiderohen raste të forcës madhore dhe përjashtimore të kësaj paprekshmërie, organet e rendit publik mund të ndërhyjnë edhe pa lejen e Administratorit të UPT.



K R E U II

STRUKTURA AKADEMIKE E UPT

Neni 5

Njësitë përbërëse të Universitetit Politeknik të Tiranës

1. UPT, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, përcakton organizimin e brendshëm akademik të tij.
2. Brenda UPT funksionojnë :
 - **njësitë kryesore**, që janë fakulteti dhe instituti i kërkimit dhe zhvillimit;
 - **njësitë bazë**, që janë departamenti dhe qendra e kërkimit;
 - **degët**, që mund të jenë njësi kryesore ose njësi bazë;
 - **njësitë ndihmëse**, janë strukturat mbeshtetese te percaktuara ne strukturen e UPT, te cilat ndihmojnë institucionin, njesite kryesore dhe njesite baze ne realizimin e veprimtarise mesimdhene, kerkimore shkencore dhe ato administrative.
 - shoqerite tregtare dhe organizatat joftimprurëse me themelues Universitetin Politeknik të Tiranës.

Njësitë kryesore, njësitë bazë, degët dhe njësitë ndihmëse krijohen, mbyllen, organizohen dhe riorganizohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe këtë statut, si pjesë e organigramës së UPT.

Neni 5-1 Fakulteti në UPT

1. **Fakulteti i UPT** (FUPT) bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor dhe profesional në fusha mësimore kërkimore të përaferta ose të ndërthurura inxhinierike. FUPT ofron programe të studimeve të ciklevë të ndryshme, në përputhje me objektivat e tij akademikë dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.
2. FUPT organizohet në njësi bazë, dhe ka në përbërjen e tij të paktën tre të tillë, nga të cilat të paktën dy duhet të jenë departamente.
3. Funksionimi i FUPT përcaktohet në rregulloren e tij.
4. UPT ka të drejtë të hapë degë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj për të ofruar programe studimi, në përputhje me kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së tij. **Dega e UPT** (DeUPT) mund të zhvillojë edhe veprimtari të tjera si kërkim shkencor, veprimtari trajnuese, shërbime për të tretë. DeUPT garanton të njejtën cilësi të veprimtarisë së saj, si në të gjitha njësitë e tjera akademike përbërëse të UPT.
5. DeUPT mund të jetë:
 - a. një njësi e veçantë në strukturën e UPT;
 - b. pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të UPT;



6. Funksionimi i DeUPT përcaktohet në rregulloren e saj.

Neni 5-2
Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit në UPT

1. **Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit në UPT**(IKZHUPT), kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si edhe merr pjesë në realizimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimit, që ofrohen nga UPT. IKZHUPT organizohet në të paktën tre njësi bazë, nga të cilat të paktën dy duhet të janë departamente.
2. Njësitë bazë të IKZHUPT kryejnë shërbime monitorimi në zbatim të misionit dhe vizionit te tyre në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Të dhënat e përfshira nga kryerja e shërbimeve të monitorimit dhe për të tretë përdoren si argumente në studimet e kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar.
3. Funksionimi i IKZHUPT përcaktohet në rregulloren e tij.

Neni 5-3
Departamenti në UPT

1. **Departamenti në UPT (DUPT)** është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënieς dhe punës mësimore-kërkimore të njësisë kryesore dhe :
 - a) përfshin fusha kërkimi të përafërtë dhe grupon disiplinat mësimore respektive;
 - b) mund të krijohet edhe nga njësi kryesore të ndryshme të UPT,
 - c) është përgjegjës për programet e studimit që ofron;
 - d) propozon programe të reja studimi dhe riorganizimin e tyre në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë;
 - e) nxit, programon, bashkërendon, zhvillon dhe menaxhon mësimdhënien sipas programeve të studimit si dhe veprimtarinë kërkimore përkatëse;
 - f) mund të ofroje shërbime për të tretë, si dhe të zhillojë veprimtari të tjera në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në rregulloret e UPT;
 - g) menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera, që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h) ka në përbërjen e tij të paktën shtatë anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën tre duhet të kenë grada dhe tituj;
 - i) mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës-akademik;
 - j) miraton kriteret e pranimit dhe propozon kuotat dhe tarifat e studimit në programet e studimit, të ofruara nga njësia bazë dhe ia përcjell Dekanatit të njësisë kryesore;
 - k) përzgjedh studentët fitues në programet e studimit që ai ofron dhe ja dërgon për miratim drejtuesit të njësisë kryesore sipas përcaktimeve në rregulloren e UPT dhe të

bz



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- njësisë kryesore përkatëse;
- l) i lind e drejta të organizohet në grupe mësimore-kërkimore, të përhershme ose të përkohshme. Këto grupe mësimore-kërkimore kanë në përbërjen e tyre të paktën pesë anëtarë efektivë si personel akademik i DUPT.
 2. Funksionimi i DUPT përcaktohet në rregulloren e tij.

Neni 5-4 Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit në UPT

1. **Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit në UPT (QKZHUPT)** ka strukturë të ngjashme me Departamentin.
2. QKZHUPT i lind e drejta të organizohet në grupe kërkimore-shkencore, të përhershme ose të përkohshme. Këto grupe mësimore-kërkimore kanë në përbërjen e tyre të paktën pesë anëtarë efektivë si personel akademik i QKZHUPT.
3. Funksionimi i QKZHUPT përcaktohet në rregulloren e saj.

Neni 6 Njësitë kryesore UPT

1. Njësitë kryesore, që bëjnë pjesë në UPT, janë të organizuar si më poshtë:
I. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
II. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
III. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
IV. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
V. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
VI. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
VII. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
VIII. Instituti i Gjeoshkencave, Enerjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)

Neni 7

Shoqëritë tregtare të Universitetit Politeknik të Tiranës

1. Universiteti Politeknik i Tiranës me qëllim përdorimin e rezultateve, njohurive, të kërkimit shkencor ka të drejtë që të krijojë shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
2. Shoqëritë tregtare që krijohen për këtë qëllim përdoren për realizimin e një aktiviteti biznesi me karakter inovativ, mbështetur në rezultatet e kërkimit shkencor të zhvilluar në kuadër të programeve universitare.
3. Krijimi i këtyre shoqërive tregtare propozohet nga Senati bazuar ne planbiznesin e paraqitur nga Administratori i Institucionit dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

4. Bordi i Administrimit shqyrton dhe vendos, në lidhje me formën e shoqërisë tregtare, vlerën dhe formën e kapitalit që do të përdoret për krijimin e saj, mënyrën e administrimit, strukturën e saj, mënyrën e raportimit etj.
5. Senati Akademik, shqyrton dhe vendos në lidhje me fushën e veprimtarisë, kalimin e të drejtave të përdorimit dlie gjëzimit të patentave, njoħurive, shpikjeve etj., të cilat do të përdoren nga shoqëria tregtare.
6. Këto shoqëri tregtare mund të krijohen nga Universiteti Politeknik i Tiranës në mënyrë ekskluzive ose në bashkëpunim me persona juridikë të tjera. Në këtë rast nga Bordi i Administrimit miratohet edhe marrëveshja për mënyrën e ndarjes së kuotave/aksioneve që do të kenë palët në këtë shoqëri. Në çdo rast Universiteti duhet të zoterojë më shumë se gjysmën e kapitalit.
7. Statuti i shoqërise miratohet paraprakisht nga Senati dhe miratohet përfundimisht nga Bordi i Administrimit.

Neni 8

Organizatat Jofimprurese te Universitetit Politeknik te Tiranes

Në Universitetin Politeknik i Tiranës me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e vlerave dhe traditave kulturore dhe historike, shkencës dhe arsimit, edukimit fizik dhe shpirtëror, si dhe për cdo drejtim tjetër në të mirë të studentëve, mund të krijojë Organizata Jofitimprurëse, në formën e shoqtave, findacioneve apo qendrave.

Veprimtaria e tyre do të rregullohet në bazë të legjisacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe ligjit per Organizatat Jofitimprurese.

Krijimi i Organizatave Jofitimprurëse dhe fusha e veprimtarisë se tyre propozohet nga Senati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit.

KREU III

ORGANET KOLEGJIALE, AUTORITETET DREJTUESE DHE ADMINISTRATIVE TË UPT

ORGANET KOLEGJIALE TË UPT

Organet kolegiale drejtuese në Universitetin Politeknik janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshilli i Etikës, Dekanati/Drejtoria e Institutit, Asambleja e personelit akademik dhe Komisionet e pérhershme.

Neni 9

Senati akademik i UPT

1. Senati është organi kolegjial më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përbushjen e misionit të tij, ne zbatim te pikes 1, te nenit 38, te Ligjit 80/2015, përgjegjës për përbushjen e misionit të UPT. SAUPT përcakton politikat e zhvillimit të UPT, programon dhe bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
2. SAUPT kryesohet nga Rektori dhe mblidhet periodikisht.
3. Funksionet kryesore të SAUPT janë:
 - a) garantimi i autonomisë universitare, lirisë akademike, mundësive të barabarta dhe të drejtave të studentëve;
 - b) propozimi i planit strategjik të zhvillimit të institucionit;
 - c) hartimi i strukturës së përgjithshme të UPT në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore të tij dhe propozimi për Bordin e Administrimit i numrit të personelit të UPT në të gjitha nivelet;
 - d) miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të UPT;
 - e) krijimi dhe garantimi i funksionimit të komisioneve të përhershëm në rang universiteti, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - f) përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit Institucional Zgjedhor;
 - g) akordimi i titujve "Profesor Emeritus" dhe "Doktor Honoris Causa" sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e UPT;
 - h) miratimi i programit vjetor të veprimtarive akademike të rëndësishme të UPT;
 - i) miratimi i rregulloreve e UPT dhe akteve e tjera institucionale;
 - j) miratimi i programeve e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimeve si dhe mbylljes së tyre, kur ato janë të mbështetura në projekt-buxhetin vjetor të UPT;
 - k) miratimi i ndryshimeve profilizuese për programe studimi të akredituara deri në masën 20% dhe njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik;
 - l) propozimi për mbylljen dhe riorganizimin e UPT, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjeter të arsimit të lartë;
 - m) vlerësimi, garantimi dhe përgjegjësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT;
 - n) miratimi i standardeve institucionale të cilësisë;
 - o) zgjedhja e përfaqësuesve të tij në Bordin e Administrimit të UPT;
 - p) miratimi i formatit të titujve universitarë të lëshuar nga UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

SAUPT, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit

- a) miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;



- b) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të UPT mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, në përfundim të vitit akademik.
- c) tarifat e shkollimit për vitin në vijim;
- d) numrin minimal dhe maksimal të studentëve për çdo program studimi të ofruar në UPT si edhe kriteret e pranimit në to;
- e) kriteret për trajtimin e veçantë të studentëve në UPT.
4. Përbërja e SAUPT është si më poshtë:
- Rektori, i cili është edhe kryetar i tij;
 - 4 anëtarë nga çdo njësi kryesore;
 - përfaqësues nga studentët e UPT, sipas përcaktimeve në kornizën ligjore në fuqi;
 - në rast se gjatë votimit rezultati është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, atëherë vota e Rektorit eshte vendimtare. Në çdo rast tjetër bëhet rivotim.
5. SAUPT mund të ketë në përbërjen e tij edhe anëtarë të jashtëm të tij, që përzgjidhen nga personalitetë të shquara të fushave që mbulon UPT.
6. Administratori i UPT mund të marrë pjesë në mbledhjet e SAUPT pa të drejtë vote.
7. Dekani/Drejtori i njësisë kryesore është anëtar i SAUPT dhe përfshihet në numrin e përfaqësuesve të saj.
8. Anëtarët e SAUPT zgjidhen nga asambletë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katervjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetekandiduar.
9. Anëtarët e SAUPT i përkasin kategorisë “Profesor” ose “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve të huaja, anëtare të OECD-së ose BE-së dhe, në mungesë të autoriteteve akademike të atyre kategorive mund të zgjidhen edhe ata që kanë gradën shkencore “Doktor” të fituar në Republikën e Shqipërisë të kategorisë lektor.
10. SAUPT ka sekretarin e tij. Ai bën zbardhjen e vendimeve të SAUPT. Detyrat e tjera të sekretarit të SAUPT përcaktohen në rregulloren e SAUPT.
11. Mandati i anëtarit të SAUPT mbaron kur:
- a) përbushet afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga UPT;
 - d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - e) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - f) kur janë konstatuar shkelje të rënda të ligjit dhe të kodit të etikës së UPT;
 - g) në rastet kur student i zgjedhur në senatin akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit. Në këtë rast ai zëvendësohet me kandidatin pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit deri në përfundim të mandatit të nisur.

12. Vendi i mbetur bosh plotësohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
13. SAUPT mblidhet në seanca të zakonshme çdo 2 muaj. Në fillim të çdo viti akademik publikohet programi i tij i punës. Ai mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me nismën e Kryetarit të tij ose me kërkesën e të paktën një të tretës së anëtarëve të tij. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari i SAUPT dhe miratohet nga anëtarët e tij. Në rastet kur senati mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së anëtarëve, rendi i ditës propozohet nga ky grup anëtarësh dhe miratohet nga anëtarët e senatit. Vendimet e SAUPT janë të vlefshme vetëm kur në votim kanë marrë pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur me ligj kërkohet shumicë e cilësuar. Rregullat mbi procedurën e votimit dhe çështje të tjera që lidhen me të, përcaktohen në rregulloren e UPT.
14. SAUPT në ushtrimin e funksionit të tij merr vendime.
15. Vendimet e SAUPT bëhen publike.

Neni 10
Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit (BAUPT) është organi më i lartë kolegjal administrativ i UPT, i cili garanton përbushjen e misionit të UPT, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. BAUPT ka këto funksione kryesore:
 - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të UPT dhe përbushjen e misionit të tij;
 - b) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e UPT, si dhe ndarjen ose bashkimin e UPT me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - c) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të UPT;
 - d) jep mendim për projekt rregulloren e UPT dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - e) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron UPT nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - f) është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
 - g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
 - h) miraton paraprakisht statutin e UPT, para se t'i përcillet SAUPT. Ky vendim i BAUPT, merret me jo më pak se tre të pestën e votave të anëtarëve të tij;
 - i) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së UPT, të hartuar nga rektorati.
 - j) përgatit marrëveshjen ndërmjet UPT dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë për rregullat e financimit;
 - k) miraton rregulloren për administrimin, financat dhe kontabilitetin;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- I) miraton kartën e auditit finansiar të UPT, planin strategjik dhe vjetor si edhe programet e angazhimit.
- m) Siguron që Administratori të informohet me raportet vjetore të auditimit të brendshëm të njësisë për mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit finansiar dhe të kontrollit, me qëllim marjen e masave përmirësimin e tij dhe hartimit të deklaratës vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- n) Ngre komisione e grupe pune për çështje dhe veprimtari të veçanta:
- nj) Miraton shpërblimin e anëtarëve të komisioneve të përhershme apo të përkohshme, anëtarëve të Senatit dhe Bordit, pas propozimit te Administratorit dhe miratimit nga Senati, si dhe trajtimin e veçantë finansiar për personelin akademik, personelin ndihmës-akademik dhe administrativ të vlerësuar shumë mirë;
- o) Përcakton fondet për realizimin e projekteve të ndryshme kërkimore- shkencore;
- p) Percakton fondet për mbështetjen financiare për organizatat joftimprurëse që krijohen në Universitetin Politeknik të Tiranës

BAUPT *me propozim* të SAUPT miraton:

- a) planin strategjik të zhvillimit të UPT dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- b) buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UPT dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- c) numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- d) miraton tarifat e studimit dhe të regjistrimit për çdo program studimi në UPT;
- e) miraton tarifat e shërbimeve ndaj të tretëve;
- f) miraton kategoritë e studentëve, që përjashtohen apo përfitojnë nga përjashtimi i tarifave, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
- g) përcakton pagat dhe masën e shpërblimeve të personelit të UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
3. BAUPT përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Numri i anëtarëve të BAUPT, që përfaqësojnë UPT përkundrejt numrit të anëtarëve të tij, që përfaqësojnë ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë, qeverisjen vendore si edhe donatorë të tjerë të mundshëm, varet nga përqindja e kontributit finansiar në buxhetin e UPT sipas përcaktimeve të kornizës ligjore në fuqi.
4. Rektori i UPT është i ftuar të marrë pjesë në mbledhjet e BAUPT pa të drejtë vote.
5. Niveli i kontributit finansiar në buxhetin e UPT nga ana e ministrisë, qeverisjes vendore, donatorëve të tjerë të mundshëm dhe vetë UPT bazohet në planin buxhetor afatmesëm të tij, me marrëveshje midis palëve të sipërpërmendura. Ky plan përditësohet çdo vit dhe në fund të vitit të tretë finansiar bëhet rivlerësimi i financimit dhe përcaktimi i pjesëmarrjes së kontribuesve në Bordin e Administrimit.

6. Drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët nuk mund të janë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij, pa të drejtë vote.
7. Mandati i anëtarit të BAUPT përfundon kur:
 - përbushet afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - institucioni emëruesh ose zgjedhës e shkarkon në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë detyrën;
 - bëhet ndryshimi i raporteve të përfaqësimit në BAUPT.
8. Shkarkimi i anëtarëve të BAUPT, përfaqësues të UPT, bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë me propozimin e SAUPT.
9. Propozimin për shkarkim të përfaqësuesve të UPT në BAUPT e bën SAUPT. Rektori i UPT i përcjell për miratim ministrit përgjegjës për arsimin e lartë propozimin për shkarkim të përfaqësuesve të UPT në BAUPT.
10. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të autoriteteve dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të organit drejtues është plotësues.
11. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e brendshme të BAUPT.

Neni 11
Rektorati

1. Rektorati në UPT është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:
 - a) Rektori;
 - b) Zëvendësrektorët;
 - c) Administratori i institucionit;
 - ç) Drejtuesit e njësive kryesore.
2. Numri i Zv. Rektorëve në UPT propozohet nga Rektori në përputhje me politikat mandatore të institucionit.
3. Zv. Rektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve të huaja, anëtarë të OECD-së ose BE-së.
 - a) Ata emërohen dhe shkarkohen nga Rektori, pas miratimit në SAUPT.
4. Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të UPT, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të UPT, si dhe ato të administratorëve të tyre.
5. Rektorati ka këto funksione kryesore:
 - a) harton planin strategjik dhe mandator të zhvillimit të UPT;

- b) harton programin vjetor të veprimtarive akademike të UPT, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në SAUPT;
 - c) Propozon prioritetet për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore dhe ja paraqet ato Administratorit të UPT dhe më pas BAUPT për miratim;
 - d) shqyrton projektbuxhetin e hartuar nga Administratori i UPT para miratimit të tij në SAUPT;
 - e) jep mendim për marrëveshjet me karakter akademik;
 - f) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - g) propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të UPT për të gjitha nivelet;
 - h) përgatit rregulloren e tij të punës, që miratohet nga SAUPT;
6. Rektorati raporton një herë në vit realizimin e planit të veprimtarive të UPT para SAUPT dhe BAUPT.
 7. Rektorati harton reportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe ia paraqet atë për miratim SAUPT dhe BAUPT, brenda muajit Janar të vitit pasardhës.
 8. Rektorati shqyrton reportin vjetor të veprimtarisë financiare para miratimit të tij në SAUPT dhe BAUPT.
 9. Detyra dhe funksione të tjera të Rektoratit përcaktohen në Rregulloren e Rektoratit të UPT.

Neni 12
Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës ngrihet pranë UPT dhe promovon e shqyrton çështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera sipas parashikimeve të kodit të etikes dhe legjislacionit në fuqi, për të gjithë personelin e UPT.
2. Këshilli i Etikës i UPT përbëhet nga një përfaqësues për çdo njësi kryesore të tij, një përfaqësues nga personeli administrativ, një nga personeli ndihmës akademik dhe një përfaqësues i studentëve në SAUPT. Kur numri i anëtarëve të Këshillit të Etikës është çift, atëherë atij i shtohet një anëtar i propozuar nga SAUPT.
3. Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen nga SAUPT, mbi bazën e propozimeve të bëra nga njësítë kryesore, Administratori për anëtarët e stafit të personelit administrativ, Rektori për personlin ndihmës akademik dhe komuniteti i studentëve të UPT.
4. Anëtarët e Këshillit të Etikës të propozuar nga njësítë kryesore të UPT dhe duhet të kenë një përvojë pune në njësinë kryesore përkatëse prej të paktën 10 vitesh.
5. Anëtarët e Këshillit të Etikës kanë mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Anëtarët e Këshillit të Etikës nuk ushtrojnë funksione drejtuese në UPT.
7. Antarët e Këshillit të Etikës zgjedhin kryetarin e tij.
8. Kodi i etikës miratohet nga SAUPT dhe BAUBT.
9. Detyrat dhe funksionet e Këshillit të Etikës përcaktohen në kodin e etikës së UPT dhe rregulloren e tij, të cilët miratohen nga SAUPT dhe BAUBT.

Neni 13

Dekanati / Drejtoria e Institutit të Kërkim-Zhvillimit

1. Dekanati / Drejtoria e Institutit të Kërkim-Zhvillimit në UPT është organ kolegjal përbëhet nga:
 - a) Dekani / Drejtori i Institutit të Kërkim-Zhvillimit;
 - b) Zëvendësdekanët / Zv. Drejtori / Zv. Drejtorët;
 - c) administratori i Fakultetit /administratori i Institutit të Kërkim-Zhvillimit;
 - d) drejtuesit e njësive bazë.
2. Dekanati/Drejtoria drejtohet nga Dekani / Drejtori i Institutit të Kërkim-Zhvillimit.
3. Numri i zv. dekanëve zv. Drejtorëve në fakultet/institut e UPT është së paku 2 (dy). Zv.Dekanët / Zv. Drejtorët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik të Fakultetit / Institutit.
4. Zëvendësdekanët/ Zv. Drejtorët përzgjidhen nga personeli akademik i njësisë kryesore respektive, të cilët kanë, sëpaku, gradën shkencore Doktor.
5. Dekanati / Drejtoria e Institutit të Kërkim-Zhvillimit ushtron këto funksione :
 - a) harton planin strategjik të zhvillimit të Fakultetit / Institutit, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të administratorit të tij;
 - b) koordinon procesin e hartimit të buxhetit sipas kërkesave të njësive bazë dhe ja paraqet administratorit të saj;
 - c) shqyrton programet e reja të studimit, të propozuara nga njësitë bazë, për përputhshmërinë e tyre me standartet e cilësisë dhe i dërgon për miratim në SAUPT;
 - d) përcjell për miratim në SAUPT projektet e kërkimit shkencor të hartuara nga njësitë bazë, kur financimi kryhet nga UPT;
 - e) monitoron dhe koordinon veprimtarinë e njësive bazë;
 - f) harton rregulloren e fakultetit dhe ja përcjell Rektoratit për miratim Asamblesë së personelit akademik;
 - g) i paraqet Rektoratit strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet, mbështetur në propozimet e njësive bazë;
 - h) shpall projektet fituese për t'u financuar nga fondet për kërkim shkencor nga të ardhurat e fakultetit / institutit, si dhe bursat për studime shkencore, që administrohen nga vetë fakulteti / instituti;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- i) miraton kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve, të cilat përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit;
 - j) miraton kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë, të cilat përcaktohen nga njësitet bazë, në përputhje me standartet e cilësisë;
 - k) miraton listën e periodikëve shkencorë, ku do të pajtohet fakulteti/instituti, si dhe titujt e librave që do të blihen nga biblioteka;
 - l) ushtron edhe funksione të tjera, që përcaktohen në rregulloren e UPT, bazuar në specifikën e secilit fakultet / institutit.
6. Në ushtrimin e funksioneve të tij Dekanati / Drejtoria shprehet me vendime.

Neni 14 Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësive kryesore në UPT ka këto funksione:
 - a) zgjedh Rektorin e UPT;
 - b) zgjedh anëtarët e SAUPT;
 - c) zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore të UPT;
 - ç) konstituon komisione te përhershme të njësisë kryesore dhe zgjedh anëtarët e tyre;
 - d) miraton strategjinë e njësisë kryesore;
 - dh) miraton rregulloren e njësisë kryesore.
3. Asambleja e personelit akademik organizohet dhe kryen veprimtarinë e saj sipas përcaktimeve në rregulloren e njësisë kryesore.

Neni 15 Komisioni i Promovimit të Titujve Akademik në UPT

1. Komisioni i përhershëm i Promovimit të Titujve Akademikë (KPTA) në UPT ka në përbërjen e tij 7 (shtatë) anëtarë.
2. Anëtarët e KPTA në UPT vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga SAUPT për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Ata mbajnë titullin “Profesor”.
4. Funksionimi i KPTA përcaktohet në rregulloren e UPT.

Neni 16 Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

1. Komisioni i përhershëm, për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në UPT mban emërtimin “Këshilli i Profesorëve”.
2. “Këshilli i Profesorëve” ngrihet mbi bazën e njësisë kryesore të UPT.
3. Numri i anëtarëve të “Këshillit të Profesorëve” në UPT ndryshon nga 5 në 7 anëtarë, në varësi nga njësia kryesore e UPT, ku ai ushtron funksionet e tij.
4. Anëtarët e “Këshillit të Profesorëve” në UPT janë personel akademik me kohë të plotë dhe mbajnë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
5. Anëtarët e “Këshillit të Profesorëve” në UPT vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga asambleja e njësisë kryesore, ku ai ushtron funksionet e tij. Ata kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
6. Funksioni i “Këshillit të Profesorëve” në UPT përcaktohet në rregulloren e UPT dhe në rregulloren e njësisë kryesore, të cilat miratohen nga SAUPT.

Neni 17 Këshilli i Programit të Studimit

1. Organizimi dhe menaxhimi i programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në nivel njësie bazë böhет nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS).
2. KPS përböhët nga personel akademik të paktën i kategorisë “Lektor” me përvojë, jo më pak se 10 vjet, në mësimdhënie pranë njësisë bazë, që ka përgjegjësinë për programin e studimit. Anëtarët e KPS janë pjesë e personelit mësimdhënës në një ose më shumë programe studimi të ciklit të pare dhe të dytë, që mbulohen nga njësia bazë, ku ata kryejnë veprimtarinë e tyre. Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinore, ku përfshihen dy ose më shumë njësi bazë, në KPS përzgjidhet ose emërohet edhe personel akademik nga njësia bazë bashkëpunuese.
3. Përbëra, përzgjedhja, emërimi dhe procedura e punës e KPS përcaktohen në rregulloren e brendshme të njësisë bazë.

AUTORITETET DREJTUESE TE UPT

Autoritetet drejtuese akademike

Autoritetet drejtuese akademike janë Rektori, drejtuesi i njësisë kryesore dhe drejtuesi i njësisë bazë.

Neni 18 Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UPT, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.



2. Rektori i UPT zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në zgjedhjen e Rektorit llogariten në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
3. Kandidatët për Rektor vetëkandidohen.
4. Kandidatët për Rektor të UPT mbajnë titullin "Profesor" vijnë nga radhët e personelit akademik të UPT ose jashtë tij.
5. Presidenti i Republikës dekreton Rektorin e UPT.
6. Rektori drejton SAUPT dhe raporton para tij.
7. Rektori, pas miratimit në SAUPT, emëron dhe shkarkon Zëvëndës Rektorët.
8. Rektori i propozon ministrit përgjegjës për arsimin e lartë shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë kryesore të UPT, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës të UPT.
9. Rektori i UPT ushtron këto funksione:
 - a) Miraton kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë pasi përeaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit;
 - b) nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në UPT;
 - c) emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues të zgjedhjeve;
 - d) nënshkruan, në emër të UPT, marrëveshje bashkëpunimi me universitetet e tjera, vendase dhe të huaja, dokumentacion e për anëtarësimin e UPT në shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, marrëveshje bashkëpunimi me subjekte vendase dhe të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë. Këto marrëveshje, protokolle e bashkëpunime i paraqiten SAUPT për ratifikim;
 - e) drejton hartimin e planit strategjik të zhvillimit të UPT dhe ndjek zbatimin e tij;
 - f) paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t'u shqyrtuar nga organet SAUPT, BAUPT dhe Këshilli i Etikës;
 - g) përfaqëson UPT në marrëdhënie akademike dhe protokollare me të tretët;
 - h) largon nga detyra personelin akademik të UPT, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij, dhe pas miratimit të komisionit "*ad hoc*", të ngritur nga SAUPT, në rastet e shkeljeve të rënda ose shkeljeve të përsëritura kornizës ligjore në fuqi dhe Kodit të Etikës së UPT.
 - i) nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë delegimi të nënshkrimit të tij;
 - j) nënshkruan titujt akademikë të lëshuar nga UPT;
 - k) ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtarë të veçanta;
 - l) delegon funksionet e tij tek Zv rektori/Zv rektorët në rast të pamundësisë, mungesës ose pushimeve.
10. Marrëdhëniet e Rektorit me organet dhe autoritet e tjera drejtuese, mënyra dhe kushtet e

ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e UPT.

11. Rektori shprehet me urdhëra dhe vendime.
12. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
13. Mandati i Rektorit mbaron kur:
 - a. përfundon afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - d. dhe në raste të tjera në përputhje me kornizën ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
 - e. Në rastin e largimit të Rektorit për shkaqe ligjore ose mospërmbushje të detyrës, ministri përgjegjës për arsimin e lartë komandon në detyrë një prej zëvendësrektorëve për një afat deri në gjashtë muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve në UPT.

Neni 19

Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT

1. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT është Dekani i FAUPT ose Drejtori i Institutit të Kërkim Zhvillimit
2. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore të UPT dhe përfaqësuesi i tij.
3. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
4. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT është personel akademik me kohë të plotë dhe zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në zgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore të UPT llogariten në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
5. Kandidati për drejtues i njësisë kryesore të UPT vetëkandidohet.
6. Kandidatët për drejtues i njësisë kryesore të UPT janë personel akademik i kategorisë "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të UPT ose dhe jashtë tij.
7. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT emërohet nga Rektori i UPT.
8. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT drejton Dekanatin / Drejtorinë dhe raporton para tij.
9. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT emëron dhe shkarkon Zv/Dekanin/ët / Zv?Drejtor/ët, që janë personel akademik me kohë të plotë i kategorisë "Lektor" ose "Profesor".
10. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT i përcjell Senatit Akademik propozimet, kërkesat, shqetësimet etj. të njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij.
11. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT i propozon Rektorit shkarkimin e drejtuesit të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të



pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës të UPT. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga Rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

12. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT i propozon administratorit të UPT shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.
13. Drejtuesi i njësisë kryesore të UPT ushtron këto funksione të tjera:
 - a) emëron drejtues të njësisë bazë, kandidatin fitues të zgjedhjeve;
 - b) përgatit propozimin përkatës për çdo vendimmarje të Dekanatit/Drejtorisë të njësisë kryesore;
 - c) përgjigjet para Dekanatit/ Drejtorisë të njësisë kryesore për mbarëvajtjen e veprimitarës së kësaj të fundit;
 - d) drejton punën për hartimin e rregullores së njësisë kryesore;
 - e) përgatit raportet vjetore të punës mësimore, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të njësisë kryesore mbështetur në raportet e njësive bazë;
 - f) nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë dhe suplementet e tyre, pa të drejtë për të deleguar nënshkrimin;
 - g) miraton listën e studentëve fitues, që pranohen ne programet e studimit që ofrohen nga njësisë kryesore përkatëse;
 - h) ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimitari të veçanta të njësisë kryesore;
 - i) përcjell zyrtarisht, në përputhje me rregulloren e UPT dhe të njësisë kryesore, projektet kërkimore-shkencore të propozuara nga personeli akademik i njësive bazë;
 - j) delegon funksionet e tij tek Zv. dekani/nët /zv. drejtor/ët në rast të pamundësisë, mungesës ose pushimeve.
14. Marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë kryesore me organet dhe autoritetet e tjera drejtuese, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e UPT dhe atë të njësisë kryesore.
15. Drejtuesi i njësisë kryesore shprehet me urdhëra dhe udhëzime brenda kompetenca të tij.
16. Mandati i drejtuesit të njësisë kryesore zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimitarinë e tij akademike.
17. Mandati i drejtuesit të njësisë kryesore mbaron kur:
 - a) përfundon afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - ç) e shkeljeve të rënda të ligjit sipas përcaktimeve në kornizën ligjore në fuqi.
18. Në rastet e krijimit të një njësie të re kryesore në UPT, drejtuesi i saj emërohet nga Rektori për një mandat me kohëzgjatje njëvjeçare, me detyrë organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të drejtuesi të asaj njësie kryesore dhe njësive përbërëse, brenda



kohëzgjatjes së mandatit.

Neni 20
Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përsaqëson atë.
2. Drejtuesi i njësisë bazë në UPT zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë.
3. Kandidati për drejtues i njësisë bazë vetëkandidohet.
4. Kandidati për drejtues i njësisë bazë është personel akademik i kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor".
5. Drejtuesi i njësisë bazë ushtron këto funksione :
 - a) emëron drejtuesit e grupeve mësimore-kërkimore / grupeve kërkimore. Procedura e emërimit të tyre përcaktohet në rregulloren e njësisë bazë;
 - b) drejton punën për hartimin e rregullores së njësisë bazë;
 - c) koordinon, kontrollon dhe menaxhon procesin mësimor, që ofron njësia bazë;
 - d) nxit, koordinon, kontrollon dhe menaxhon veprimtarinë kërkimore-shkencore të njësisë bazë;
 - e) raporton para Dekanatit/Drejtorisë të njësisë kryesore për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë bazë;
 - f) përcjell vendimet dhe propozimet e njësisë bazë instancave përkatëse si përcaktohet në rregulloren e UPT dhe të njësive kryesore;
 - g) përgatit raportet vjetore të punës mësimore, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të njësisë bazë, mbështetur në raportet e grupeve mësimore-kërkimore / grupeve kërkimore, kur ato ekzistojnë;
 - h) krijon komisionin "ad hoc" për përzgjedhjen e studentëve fitues në programet e studimit të ofruara nga njësia bazë dhe menazhon procedurën e pëzgjedhjes;
 - i) krijon komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimitari të veçanta të njësisë bazë;
 - j) emëron anëtarët dhe koordinatorin e **Këshillit të Programit të Studimit (KPS)** për hartimin, rishikimin dhe riorganizimin e çdo programi studimi, të ofruar nga njësia bazë;
 - k) emëron anëtarët dhe kryetarin e komisioneve të provimeve dhe të diplomimit;
 - l) cakton anëtarët e njësisë bazë në komisionet "ad-hoc" të punësimit të personelit akademik.
6. Drejtuesi i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë



bazë.


7. Drejtuesi i njësisë bazë merr vendime dhe nxjerr urdhëra për menaxhimin akademik të saj dhe i bën ato publike, brenda kompetencave të tij.
8. Mandati i Drejtuesi i njësisë bazë zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
9. Mandati i Drejtuesi i njësisë bazë mbaron kur:
 - a) përfundon afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - ç) e shkeljeve të rënda të ligjit sipas përcaktiveve të kornizës ligjore në fuqi.
10. Në rastet e krijimit të një njësie të re bazë në UPT, drejtuesi i saj emërohet nga dekani për një mandat me kohëzgjatje deri në zhvillimin e zgjedhjeve të drejtuesit të njësisë bazë.
11. Marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë bazë me organet dhe autoritetet e tjera drejtuese si edhe ushtrimi i funksioneve të tij të tjera përcaktohen në rregulloren e Fakultetit dhe të UPT.

Autoritetet administrative në UPT

Autoritetet drejtuese administrative në UPT janë: Administratori i UPT dhe Administratori i njësisë kryesore. Autoritet administrativ është dhe administratori i njësisë bazë, në rastet kur ai ekziston.

Neni 21 Administratori i UPT

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financier të UPT.
2. Ai është përfaqësues ligjor i UPT për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktiveve të kornizës ligjore në fuqi.
3. Administratori i UPT përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kritereve të përcaktuara nga BAUPT. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga SAUPTemik.
4. Administratori i UPT duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Kritere të tjera shtesë mund të përcaktohen nga BAUPT.
5. Emërimi i administratorit të UPT bëhet nga BAUPT.
6. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ në UPT.
7. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij BAUPT dhe SAUPT, sa herë që i kërkohet.



8. Administratori i UPT kryen këto funksione:

- a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UPT dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
- b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim BAUPT dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
- c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të UPT në strukturat e varësisë së tij;
- d) zbaton të gjitha vendimet e BAUPT dhe të SAUPT me karakter financier dhe administrativ;
- e) plotëson kërkesat e paraqitura nga rektori i UPT, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare
- f) i paraqet BAUPT dhe SAUPT raportin mbi veprimtarinë financiare të UPT në përfundim të vitit akademik;
- g) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të UPT për çështje të administrimit të përditshëm;
- h) propozon studime për zhvillimin perspektiv të UPT;
- i) merr pjesë në organizimin e studimit të tregut në lidhje me shërbimet ndaj të tretëve, që mund të ofrojnë njësitë bazë të UPT;
- j) mban përgjegjësi për administrimin financier të UPT sipas legjislacionit në fuqi
- k) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë pas miratimit të BAUPT;
- l) drejton procedurat e rekrutimit të personelit administrativ dhe personelit të shërbimit sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe procedurave të miratuara nga Bordi i Administrimit;
- m) përfaqëson institucionin përpara institucioneve shtetërore, apo subjekteve të tjera për çështje administrative dhe financiare: Nënshkruan dokumentet e hartuara me karakter administrativ dhe financier, që dalin në emër të UPT-së;
- n) mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit;
- o) kontrollon zbatimin e rregullave të etikës nga administrata dhe merr masat e duhura disiplinore ndaj shkeljeve të konstatuara nga Këshilli i Etikës së UPT;
- p) i paraqet për miratim Bordit të Administrimit, rregulloren e brendshme, strukturën dhe kriteret e emërimit të personelit administrativ;
- q) emëron dhe shkarkon personelin administrativ të UPT në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- r) miraton planet vjetore të punës së njësive në varësi të tij strukturore e funksionale dhe kontrollon realizimin e tyre.
- s) në bashkëpunim me strukturat akademike dhe administrative të universitetit, harton dhe ndjek realizimin e një plani afatmesëm/afatgjatë me detyra të sakta e

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

me afate kohore, për gjenerimin e të ardhurave alternative, duke synuar rritjen graduale pavarësisë financiare, përmes rritjes së përqindjes së të ardhurave të universitetit në totalin e buxhetit të tij.

- t) propozon në Bordin e Administrimit ndryshimin e destinacionit të fondeve nga një njësi shpenzuese në një tjeter;
- u) shqyrton kërkesat dhe miraton rishpërndarjet brenda të njëjtë artikull buxhetor të shpenzimeve korrente, pa tejkaluar limitet buxhetore të miratuara nga Bordi i Administrimit;
- v) ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e Titularit të Autoritetit Kontraktor - Universiteti i Politeknik i Tiranës, bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike;
- w) administratori mund të delegojë një ose disa nga kompetencat e tij tek autoritet apo strukturat vartëse, sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurave Administrativ në RSH-së;
- x) nxjerr urdhra dhe vendime në funksion të drejtimit të veprimtarisë administrative e financiare te institucionit.

9. Administratori i UPT shkarkohet nga BAUPT me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

10. Funksionet e tjera të Administratorit përcaktohen në rregulloren e UPT dhe të BAUPT.

Neni 22 Administratori i njësisë kryesore në UPT

1. Administratori i njësisë kryesore eshte autoriteti më i lartë administrativ përgjegjës për mirëfunkcionimin financier dhe administrativ të saj.
2. Administratori i njësisë kryesore zgjidhet me konkurs, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga BAUPT.
3. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.
4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjeter, akademik apo administrativ.
5. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij Administratorit të UPT, si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore për veprimtarinë e tij.
6. Administratori i njësisë kryesore propozon shkarkimin e administratorëve të njësive bazë.
7. Funksionet e administratorit të njësisë kryesore janë:
 - a) realizon administrimin e përditshëm financier të njësisë kryesore;
 - b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;



- c) plotëson kërkesat e drejtuesve të njësisë kryesore dhe të njësive bazë, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - d) bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.
 - e) në bashkëpunim me njësitë bazë bën propozime për planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore;
 - f) merr pjesë në organizimin e studimit të tregut në lidhje me shërbimet ndaj të tretëve, që mund të ofrojnë njësitë bazë, përbërëse të njësisë kryesore;
 - g) harton projekt-buxhetin vjetor të njësisë kryesore, në bazë të propozimeve të njësive bazë;
 - h) mban përgjegjësi për administrimin finanziar të njësisë kryesore sipas legjisacionit në fuqi;
 - i) Mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e njësisë kryesore.
8. Administratori i njësisë kryesore shkarkohet nga Administratori i UPT pas miratimit për shkarkimin e tij nga BAUPT.
9. Funksionet e tjera të Administratorit të njësisë kryesore përcaktohen në rregulloren e UPT dhe të BAUPT.

Neni 23
Administratori i njësisë bazë në UPT

1. Ekzistenza e Administratorit të njësisë bazë në UPT dhe emërimi i tij bëhen sipas përcaktiveve në kornizën ligjore në fuqi.
2. Në mungesë të Administratorit të njësisë bazë, funksionet e tij kryhen nga Administratori i njësisë kryesore përkatëse.
3. Administratori i njësisë bazë në UPT është përgjegjës për mirëfunkcionimin finanziar dhe administrativ të saj.
4. Administratori i njësisë bazë zgjidhet me konkurs, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga BAUPT.
5. Administratori i njësisë bazë duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku tre vjet në këto fusha.
6. Administratori i njësisë bazë nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjeter, akademik apo administrativ.
7. Administratori i njësisë bazë i raporton për veprimtarinë e tij, Administratorit të njësisë kryesore, Administratorit të UPT, si dhe informon drejtuesin e njësisë bazë për veprimtarinë e tij.



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

8. Drejtuesi i njësisë bazëose Administratori i njësisë kryesorei propozon Administratorit të UPT shkarkimin e administratorit të njësisë bazë.
9. Funksionet e administratorit të njësisë bazë në UPT janë:
 - a) realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë bazë;
 - b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë bazë;
 - c) plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë bazë, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - d) bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë bazë për çështjet themelore të administrimit të saj;
 - e) merr pjesë në organizimin e studimit të tregut në lidhje me shërbimet ndaj të tretëve, që mund të ofrojë njësia bazë;
 - f) imban përgjegjësi për administrimin financiar të njësisë bazë sipas legjislacionit në fuqi.
10. Administratori i njësisë bazë shkarkohet nga Administratori i UPT pas propozimit të Administratorit të njësisë kryesore dhe miratimit për shkarkimin e tij nga BAUPT.

KREU IV

PRONAT, FINANCIMI DHE SHËRBIMET NË UPT

Neni 24

Autonomia financiare e Universitetit Politeknik të Tiranës

1. UPT funksionon sipas parimit të autonomisë financiare e cila garantohet nëpërmjet të drejtës :
 - a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga market dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;
 - c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të UPT;
 - d) për të përcaktuar tarifat e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - e) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që UPT zoteron ligjërisht, në përputhje me misionin e tij;
 - f) UPT mund të përcaktojë tarifa të ndryshme për përdorimin e pronës së paluajtshme dhe pronësisë intelektuale.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

2. UPT harton planin buxhetor afatmesëm i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.
3. Të gjitha të ardhurat e krijuara përdoren nga UPT dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.
4. Përdorimi i pronave të UPT për përfitime personale është shkelje e rëndë ligjore.

Neni 25 Burimet e financimit të UPT

1. UPT financohet nga:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) pagesat e studentëve për arsimin;
 - c) të ardhurat e krijuara nga të mësuarit për gjatë gjithë jetës;
 - d) të ardhurat për shërbimet e kryera për subjekte publike, private vendase dhe të huaja si edhe ndaj studentëve;
 - e) oponencat e projekteve;
 - f) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të treta;
 - g) donacione, dhurata, trashëgimitë;
 - h) të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kërkimore-shkencore;
 - i) të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e aktiveve të cilat janë në administrim të UPT, për palët e treat, në formën e kontratave të qiradhënieς apo me forma të tjera kontraktimi.
 - j) Të ardhura nga kryerja e shërbimeve të specializuara në të gjitha fushat e ekspertizës së UPT.
 - k) burime të tjera të ligjshme financimi.
3. Të ardhurat e krijuara sipas pikes 1 të këtij neni, përveç të ardhurave nga buxheti i shtetit, derdhen në llogarinë e UPT dhe përdoren sipas mënyrës së përcaktuar në Rregulloren e miratuar nga Bordi i Administrimit. “*Mbi krijimin dhe përdorimin e fondeve të krijuara nga të ardhurat e UPT*”.
4. Të ardhurat e përfituar nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, oponencat, hartimi dhe pjesmarrija në projekte të kërkim zhvillimit, nga transferimi i teknologjive, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik i UPT, ndahet ndërmjet personelit akademik dhe UPT-së në përputhje me rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin në UPT.
5. Angazhimi i personelit akademik të UPT në veprimtari kërkimi e zhvillimi dhe shërbime për të tretët, nuk duhet të cënojë veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor të planifikuar.

Neni 26 Tarifa e Studimit



1. Në kuadër të autonomisë financiare, UPT ka të drejtë të përcaktojnë tarifat e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Tarifa e studimit përfshin tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit.
3. Tarifa e studimit miratohet me vendim të Bordit të Administrimit pasi është marrë mendimi paraprak i Senatit Akademik të UPT, për çdo program studimi, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Përashtimi nga tarifa e studimit për studentët që ndjekin një program studimi në ciklin e parë si dhe një program të integruar të studimeve, bëhen me VKM për studentët që nuk kanë mundësi financiare për ti përballuar ato.
5. Përashtimi ose reduktimi nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë dhe që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar koston e studimeve, bëhet me vendim të Bordit të Administrimit, pasi është marrë mendimi paraprak i Senatit Akademik.

Neni 27
Shpërndarja e të ardhurave të krijuara nga UPT

1. BAUPT, me propozim të Administratorit të UPT, vendos për shpërndarjen e të ardhurave të krijuara nga UPT, në bazë të kërkesave dhe kontributit të njësive bazë dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. BAUPT mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Neni 28
Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formën e grantit sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, i cili përfshin:
 - Fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturën akademike;
 - Fondin e projekteve konkurente për zhvillimin e institucionit.
 - b) Granti i mësimdhënies përfshin:
 - Fondin për UPT;
 - Fondi i mbështetjes studentore.
 - c) Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuarë përfshin fondet për kërkimin shkencor.



**Neni 29
Hartimi i buxhetit të UPT**

1. Struktura e hartimit të buxhetit të UPT bëhet sipas modelit të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave.
2. Projektbuxheti vjetor hartohet nga Administratori, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UPT dhe në planin buxhetor afatmesëm.
3. Projektbuxheti vjetor detajohet për çdo njësi bazë dhe kryesore të UPT.
4. Buxheti vjetor dhe afatmesëm i UPT miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik.

**Neni 30
Pronat në administrim të UPT**

1. UPT e ushtron veprimtarinë në pronat e paluajtshme të cilat i kanë kaluar në administrim me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. UPT ka detyrimin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pronave në administrim.
3. UPT ka të drejtë të krijojë pasuri të paluajtshme dhe ti administrojë ato në funksion të interesit të tij.

**Neni 31
Auditimi i brendshëm**

1. Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim përmes një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike përtësuar vlerë e përmirësuar veprimtarinë e Universitetit Politeknik të Tiranës.
2. Njësia e auditimit të brendshëm në Universitetin Politeknik te Tiranës ka varësi organizative dhe funksionale tek Bordi i Administrimit dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bördi i Administrimit. BAUPT mund të kërkojë auditime të brendshme shtesë.
3. Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Brendshem te Universitetit Politeknik te Tiranës, e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.

**Neni 32
Shërbimet në UPT**

1. UPT, nëpërmjet njësive përbërëse të tij, kryen shërbime në nivel kombëtar dhe për të tretët, në mbështetje të zhvillimit të tij.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

2. Shërbimet realizohen në përputhje me kushtet dhe modalitetet e përcaktuara në kontratën që lidhet midis UPT dhe palëve të interesuara.
3. Tarifat e shërbimeve miratohen nga Bordi i Administrimit, me propozim të Administratorit të Institucionit, sipas kërkesave të njësive kryesoredhe/ose atyre bazë.
4. Format e shërbimeve, projektimi dhe realizimi i tyre përcaktohen në “*Rregulloren e kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT*”.

KREU V

Neni 33 Personeli i UPT

1. Personeli i UPT përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli i UPT mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë, ose me kohë të pjesshme.

Neni 34 Statusi i personelit akademik të UPT

1. Personeli akademik gjëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësítë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.
2. Personeli akademik gjëzon liri akademike në këto drejtime të veprimitarisë së tij, në:
 - a) mësimdhënie;
 - b) punë kërkimore-shkencore;
 - c) kontribut institucional;
 - d) kontribut professional.
3. Liria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë pedagogjike e shkencore dhe nuk presupozon përjashtimin nga vlerësimi i performancës së personelit akademik. Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të UPT dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.
4. Personeli akademik nuk mund të largohet apo të zëvendësohet, pa miratimin e tij, gjatë kryerjes së punës kërkimore–shkencore në një projekt të ndjekur prej tij, përvèç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara, të parashikuara në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.
5. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me statutin dhe rregulloret e UPT.
6. Personeli akademik, me kohë të plotë, apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnje funksion administrimi në UPT, me përjashtim kur zgjidhet anëtar në BAUPT.
7. UPT garanton krijimin e kushteve për zhvillimin e lirë të karrierës akademike për të gjithë personelin akademik të tij, në përputhje me misionin dhe politikat institucionale.
8. Personeli akademik e humbet statusin kur perfundon/zgjidhet kontrata.
9. Personeli akademik mund të ndihmohet financiarisht në rast sëmundjeje apo fatkeqësish, kur ato nuk mbulohen nga përcaktimet e kornizës ligjore në fuqi, në përputhje me mundësitë e UPT.

10. Në rast se anëtari i personelit akademik konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim joetik ndaj tij, i drejtohet Këshillit të Etikës të UPT, për këtë çështje.

Neni 35
Personeli akademik

1. Personeli akademik në UPT ka këto të drejta kryesore:
 - a) Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - b) Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit në përputhje me profilin e tij;
 - c) Të ushtrojë lirinë e shprehjes;
 - d) Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Universitetit Politeknik të Tiranës, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret përkatëse të UPT;
 - e) Të publikojë rezultatet e punës kërkimore dhe krijuese, brenda përcaktimeve që kanë të bëjnë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale;
 - f) Të marrë pjesë në veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve në zhvillim të institucionit;
 - g) Të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit në funksion të promovimit të titullit /gradës shkencore;
 - h) Të përcaktojë lirisht metodat e procesit mësimor, në kuadër të programeve mësimore dhe në përputhje me politikat e UPT;
 - i) Të ketë ngarkesë mësimore në përputhje me kornizën ligjore fuqi dhe politikat e brendshme të UPT;
 - j) Të përfitojë shpërblim për punën e kryer në bazë të kontributeve individuale;
 - k) T'i ruhet vendi i punës gjatë kohës që kryen punë kërkimore –shkencore në një projekt të ndjekur prej tij;
 - l) Të kryejë detyra të larta në administratën publike për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje duke ruajtur statusin e tij;
 - m) Të paraqesë ankesë pranë Këshillit të Etikës, nëse konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim jo etik ndaj tij;
 - n) Të përfitojë pushim vjetor jo më pak se 40 ditë pune.
1. Personeli akademik në UPT ka këto detyra kryesore:
 - a) Të njohe, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe kornizën ligjore në fuqi;
 - b) Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, sipas orarit te punës dhe ta shfrytëzojë për kryerjen e detyrave të ngarkuara. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- c) Të rrisë aftësitë profesionale dhe akademike si edhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;
 - d) Të mos kërkojë ose pranojë asnje përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe shpërblimeve të tjera, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe Rregulloren e UPT;
 - e) Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku është caktuar anëtar;
 - f) Të respektojë urdhërat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësít;
 - g) Të mbrojë interesat e ligjshme të institucionit, të ruajë të dhënat konfidenciale të UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe rregulloren e UPT;
 - h) Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në UPT;
 - i) Të zbatojë etikën institucionale në respektim të kodit ttë UPT dhe figurës profesionale gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike.
2. Të drejtat dhe detyrimet e tjera të personelit akademik në UPT përcaktohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe Rregulloret e UPT.

Neni 36 **Kategoritë e personelit akademik të UPT**

1. Personeli akademik i UPT me orientim mësimor dhe kërkimor shkencor, kryen disa lloje veprimtarish që ndahen në:
 - a) Veprimtari të mësimdhënies dhe këshilluese për studentët;
 - b) Veprimtari të kërkimit shkencor;
 - c) Veprimtari mbështetëse për zhvillimin e UPT dhe shërbime për të tretët;
 - d) Veprimtari të tjera, (transferim teknologjie dhe inovacioni).
2. Personeli akademik i UPT me orientim kerkimor shkencor, kryen disa lloje veprimtarish që ndahen ne:
 - a) Veprimtari të kërkimit shkencor;
 - b) Veprimtari të mësimdhënies dhe këshilluese për studentët;
 - c) Veprimtari mbështetëse për zhvillimin e UPT dhe shërbime për të tretët;
 - d) Veprimtari të tjera, (transferim teknologjie dhe inovacioni).
3. Personeli akademik i UPT sipas rolit dhe veprimtarise që kryen ndahet ne kategorite e meposhtme:
 - a) Profesorë;
 - b) Lektorë;
 - c) Asistent-lektorë;



4. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve, ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asocuar". Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
5. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkimi-shkencor para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
6. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i Shkencave" dhe të përbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
8. Norma e ngarkesës mësimore për çdo kategori të personelit akademik të UPT përcaktohet nga SAUPT duke marrë në konsideratë propozimet e ardhura nga njësitë bazë dhe kryesore të UPT dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
9. Mbingarkesa akademike e çdo kategorie të personelit akademik të UPT përcaktohet dhe shpërblehet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe rregulloret e UPT.
10. Numri i përgjithshëm i personelit të UPT propozohet nga SAUPT dhe miratohet nga BAUPT.

Neni 37
Kontributi i personelit akademik në strukturat drejtuese të UPT

Personeli akademik i kategorisë "lektor" ose "profesor", me të paktën 10 vite përvojë pune me kohë të plotë në UPT mund të angazhohet për një kohë të përcaktuar, duke ruajtur statusin e tij, në strukturat drejtuese të UPT, në përputhje me organigramën e tij. Në këtë rast, ngarkesa e tij mësimore dhe kërkimore-shkencore mund të jetë e reduktuar dhe përcaktohet në aktin e emërimit të tij. Niveli i pagës propozohet nga Rektori dhe miratohet nga BAUPT.

Neni 38
Titujt e Personelit Akademik të UPT

1. UPT promovon dhe jep titujt akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asocuar". Kjo ë drejtë e UPT buron nga plotësimi i kritereve ligjore, pasi:



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- a) ushtron veprimitari akademike dhe kërkimore-shkencore, në mënyrë të vazhdueshme, me shume se dhjetë vite;
 - b) është institucion i akredituar;
 - c) ka të punësuar si personel akademik me shume se tetëmbëdhjetë anëtarë të personelit akademik që mbajnë titullin "Profesor", me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar, si dhe ka pesë pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin profesor në çdo njësi kryesore - pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin "Profesor" në njësinë kryesore, konsiderohet personeli akademik, i cili merr pjesë aktive në programet e studimit dhe/ose të kërkimit shkencor të njësisë kryesore respektive;
 - d) përbush kriteret e tjera shtesë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
-
2. UPT mbështet finansiarisht personelin akademik në botime dhe pjesëmarrje në veprimitari shkencoreme pikësynim përparimin në karrierën akademike të tij.
 3. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij akademike dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor Emeritus".
 4. Procedura e promovimit dhe dhënies së titujve akademikë përcaktohen në rregulloren e UPT dhe atë të KPTA.

Neni 39 Personeli akademik i ftuar në UPT

1. Për nevoja të procesit mësimor, njësitë bazë të UPT, kanë të drejtë të kërkojnë për punësim me kontratë për periudha të shkurtra kohe studjues apo personalitete të fushës korresponduese vendas ose të huaj.
2. Përzgjedha e personelit akademik të ftuar bëhet duke kombinuar nevojën e njësise bazë për veprimitari të mësimdhënies ose kërkimit shkencor, me nivelin e tyre të kualifikimit.
3. Kontrata nënskrhuhet nga Rektori duke parashikuar të gjithë elementët që përban korniza ligjore në fuqi. Kriteret e tjera të përzgjedhjes dhe të punësimit si edhe procedurat sipas pikave 2 dhe 3 të këtij nenit, përcaktohen në rregulloren e UPT, në përputhje me kornizën ligjore ne fuqi.
4. Kriteret specifike të perzgjedhjes përcaktohen në rregulloret e njësive bazë të UPT.
5. Shpenzimet dhe masa e shpërblimit për personelin akademik të ftuar përcaktohen nga BAUPT dhe përballohen nga të ardhurat e njësive kryesore ku ata kryejnë veprimitarinë akademike.

Neni 40 Viti akademik sabatik në UPT

1. Personeli akademik me titujt "Lektor" dhe "Profesor" ne UPT, me miratim të njësisë bazë ku ai kryen veprimtarine e tij akademike, ka të drejtë të shkëputet për periudha kohore deri në një vit, njëherë në çdo 7 vjet, për të punuar për rritjen e nivelit të tij akademik.
2. Gjatë kesaj periudhe, këtij personeli akademik nuk i ngarkohet asnjë detyrë mësimdheneje ose kërkimi shkencor. Ai mund të ndjekë edhe kurse kualifikimi jashtë UPT.
3. Kandidati paraqet pranë njësisë bazë kërkesën për vitin sabatik dhe programin e punës së tij për përparimin akademik. Bazuar në këtë program, njësia bazë bën miratimin, ose jo, të kryerjes së vitit sabatik të kërkuar.
4. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell Rektorit për vendimarrje miratimin e njësisë bazë për vitin sabatik. Rektori merr vendim dhe firmos marrëveshjen përkatëse në rast miratimi.
5. Në përfundim të vitit sabatik, kandidati është i detyruar që të paraqesë raportin përfundimtar të punës së kryer dhe rezultatet e përparimit të tij akademik pranë njësisë bazë dhe një kopje të tij dekanit/drejtorit të njësisë kryesore.


Neni 41
Personeli ndihmës-akademik në UPT

1. Personeli ndihmës-akademik ndahet në personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës-akademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen:
 - a) laborantët;
 - b) teknikët.
3. Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional.

Neni 42
Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik në UPT

Punësimi i personelit akademik


1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë, ku do të shërbejë dhe miratohen nga Rektori i UPT. Kriteret e



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

përgjithshme të punësimit përcaktohen në rregulloren e UPT, ndërsa ato specifike në rregulloren e njësisë bazë.

2. Personeli akademik me kohë të plotë në UPT duhet të ketë një notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, së paku 85/100.
3. Personeli akademik me kohë të pjesshme në UPT duhet të ketë një notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, së paku 75/100.
4. Vendet e punës për personelin akademik me kohë të plotë fitohen me konkurim. Konkursi në UPT do të drejtohet nga një komision “ad-hoc”, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse.
5. Komisioni “ad-hoc” për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të plotë përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët:
 - tre anëtarë i përcakton njësia bazë, ku do të kryhet punësimi;
 - një anëtarë përcakton drejtuesi i njësisë kryesore;
 - një anëtar e përcakton Drejtoria e Burimeve Njerëzore të UPT.
6. Anëtarët e përcaktuar nga njësia bazë duhet të kenë përvojë jo më pak se 7 vite punë në UPT. Të paktën njëri prej tyre duhet të ketë ekspertizë në fushën akademike, ku do të punësohet kandidati.
7. Njësia bazë i përcjell propozimin për anëtarët e komisionit “ad-hoc” për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të plotë dekanit/drejtorit të njësisë kryesore, i cili i bashkangjit propozimin për përfaqësuesin e njësisë kryesore dhe ja përcjell atoRektorit të UPT.
8. Rektori i UPT në bazë propozimit të njësisë kryesore dhe atij të Drejtorisë së e Burimeve njerëzore të UPT për anëtarin e pestë, miraton komisionin “ad-hoc”.
9. Procedura e punësimit për personelin akademik në UPT kalon në këto faza:
 - njësia bazë përcakton nevojat dhe kriteret specifike për vendin e punës vakant;
 - komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe ja përcjell rektorit të UPT për miratim;
 - Rektori i UPT shpall kandidatin fitues dhe lidh kontratën e punës me të.
10. Procedura e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme përcaktohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të UPT, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të UPT dhe miratohet nga Rektori.
11. Në përputhje me këtë procedurë njësia bazë, ku do të punësohet personeli akademik me kohë të pjesshme, ngrë një komision “ad-hoc” të përbërë nga tre anëtarë të tij, të cilët duhet të kenë përvojë jo më pak se 5 vite punë në UPT dhe i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore.
12. Komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe i përcjell vendimin e tij drejtuesit të njësisë kryesore.



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

13. Drejtuesi i njësisë kryesore ja përcjell atë Rektorit të UPT për shpalljen e kandidatit fitues dhe lidhjen e kontratës së punës me të.
14. Procedura e detajuar e punësimit të personelit akademik në UPT përcaktohet në rregulloren e tij.

Neni 43 Punësimi i personelit ndihmës-akademik

1. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik propozohen nga njësia bazë ose kryesore ku ai do të shërbejë, bazuar në nevojat e tyre dhe ato miratohen nga Rektori i UPT.
2. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit “ad-hoc”, si edhe të përzgjedhjes së personelit ndihmës-akademik janë në përputhje me përcaktimet e bëra në Rregulloren e punësimit të personelit ndihmës-akademik.

Neni 44 Dispozita të tjera

1. Rektori i UPT bën miratimin përfundimtar të kandidatit fitues dhe lidh kontratën me të në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në një institucion të arsimt të lartë nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimt të lartë brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimt të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të rektorit, si edhe në marrëveshje mes institacioneve.
3. Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime që realizohen në UPT, ku ai është i punësuar me kohë të plotë, nuk konsiderohet si dypunësim brenda institucionit.

Neni 45 Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik në UPT

1. Personeli akademik i UPT i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor” shërben në detyrë sipas përcaktimeve në kornizën ligjore në fuqi, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur në nevojat e UPT dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe më pas, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme, sipas rasteve të mëposhtme:
 - a) kur ngarkesa mësimore është e madhe dhe ka mungesë të personelit akademik të kualifikuar për mbulimin me standarde të programeve të studimit, që ofrohen në UPT;
 - b) kur ai është anëtar ose drejtues i një projekti kërkimor-shkencor në proces.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

2. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike vendase apo të huaj për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje ose në mbështetje institucionale të UPT për një periudhë të përcaktuar, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me Rektorin e UPT. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet nëvendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.
3. Personeli akademik i kategorisë “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes ai mund të zëvendësohet nga personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtari i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.
4. UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe nevojat e tij të brendshme lidh kontrata me personelin akademik që mban titullin “Profesor Emeritus” pasi merr paraprakisht miratimin e BAUPT.
5. Personelit akademik i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur nuk përbush detyrimet e përcaktuara në kontratë, kur shkel statutin dhe/ose rregulloren e UPT, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Neni 46 Personeli administrativ në UPT

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga BAUPT, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Neni 47 Punësimi i personelit administrativ në UPT

1. Punësimi i personelit administrativ në UPT bëhet me konkurs publik.
2. Kriteret e punësimit përcaktohen në rregulloren e BAUPT, bazuar në nevojat e UPT.
3. Konkursi i punësimit të personelit administrativ në UPT do të drejtohet nga një komision “ad-hoc”, me përbërje sipas përcaktimeve në rregulloren e BAUPT.
4. Procedurat për përzgjedhjen e kandidatit fitues i referohen procedurave të punësimit të miratuara nga BAUPT.
5. Administratori i UPT bën miratimin përfundimtar të kandidatit fitues dhe lidh kontratën me të në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

KREU 6

STUDENTI I UPT

Neni 48

Statusi i studentit të UPT

1. Çdo person fiton statusin e studentit me regjistrimin në UPT dhe e humbet atë me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse si edhe në raste të tjera të çregjistrimit të tij, në përputhje me rregulloren e UPT.
2. Student i regjistruar në një program të dhënë studimi në UPT, në një vit të dhënë të atij programi studimi si edhe në një vit të dhënë akademik është çdo person, i cili përbush:
 - detyrimet minimale akademike për të ndjekur studimet në atë program studimi dhe në atë vit studimesh të tij;
 - detyrimet financiare në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;si edhe :
 - ka plotësuar formularin e regjistrimit;
 - ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë sekretarisë mësimore të njësië kryesore, ku do të kryejë studimet;
 - ka lexuar statutin dhe rregulloren e UPT si edhe rregulloret e njësisë kryesore dhe bazë, pranë të cilave do ai do të kryejë studimet dhe i ka pranuar ato në përmjet firmosjes së fletës së fundit të formularit të regjistrimit.
3. Lista e detyrimeve akademike, e dokumentacionit për regjistrim si edhe formulari tip i regjistrimit të studentëve jepen në rregulloren e UPT.

Neni 49

Të drejtat e studentëve të UPT

1. Studentët e UPT kanë të drejtë:
 - a) Të përfaqësohen në organet kolegiale të UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me këtë statut.
 - b) Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në kornizën ligjore në fuqi si dhe shpërblime të veçanta, që administrohen nga UPT dhe miratohen nga BAUPT.
 - c) Të shprehin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të UPT.
 - d) Të ndjekin leksione, seminare/ushtrime dhe të gjitha veprimitaritë e tjera mësimore shkencore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre.
 - e) Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera, që UPT ofron për studentët.
 - f) Të organizohen për çështjet e tyre në nivel institucional, njësie kryesore apo njësie bazë.

- g) Të pajisen me Kartën e Studentit për çdo vit akademik, që është dokument unik, me anë të të cilit, ata përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- h) Kriteret dhe procedurat përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit përcaktohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- i) Kategoritë e shërbimeve, që ofrojnë entet shtetërore, publike dhe private përcaktohen nga korniza ligjore në fuqi.

**Neni 50
Detyrimet e studentëve të UPT**

1. Studentët e UPT janë të detyruar:
 - a) të zbatojnë rregullat e pëcaktuara në rregulloren e UPT si edhe të njësive kryesore dhe bazë të tij, ku ata kryejnë studimet;
 - b) t'u kushtojnë vëmendje studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
 - c) të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - d) të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në rregulloren e UPT;
 - e) të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjera.
2. Studentët e UPT janë përgjegjës për pasojat, që mund të rrjedhin nga mosnjohja e këtyre detyrimeve.

**Neni 51
Organizmat e studentëve të UPT**

1. Studentët e UPT gjëzojnë të drejtën e organizmave të tyre, të cilat janë të pavarura, dhe nuk zhvillojnë veprimtari politike ose partiake.
2. Këto organizma promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese kolegiale të UPT, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve të tij.
3. Organizmat e studentëve të UPT funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, statutit dhe rregullores së tyre, në nivel institucional dhe/ose njësie kryesore dhe bazë.
4. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloret e brendshme, të cilat hartohen në përputhje me këtë statut dhe kornizën ligjore në fuqi.
5. Organizmat e studentëve të UPT shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.

Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

6. UPT mbështet organizmat e studentëve të tij dhe mund të financojë veprimtari të tyre me miratim të BAUPT.
7. UPT mbështet organizmat e studentëve të tij dhe promovon në mënyrë të veçantë organizimin e të diplomuarve të tij "Alumni" nëpërmjet Drejtorisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.



K R E U VII

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË UPT

Neni 52

Format e studimeve dhe pranimi në UPT

1. Format e studimeve në UPT janë:
 - a) studime me kohë të plotë;
 - b) studime me kohë të zgjatur.
2. Studimet me kohë të zgjatur, në UPT, janë të kufizuara dhe mund të ofrohen vetëm në:
 - a) programet e studimit një deri në dy vjeçare me karakter profesional;
 - b) programet e ciklit të dytë "Master Profesional";
 - c) programet e ciklit të tretë "Master Ekzekutiv".

Programet e studimit, që jepin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.
3. Propozimi i secilës nga format e mësipërme të studimit bëhet nga UPT, gjatë hartimit/riorganizimit të një program studimi dhe miratohet nga ministria përgjegjëse sipas kornizës ligjore në fuqi.
4. Kuotat e pranimit të studentëve në UPT, në të gjitha programet e studimit, bëhen me vendim të SAUPT, mbështetur në propozimet e njësive bazë, miratimin e njësive kryesore dhe të BAUPT, në përputhje me standartet shtetërore, kapacitetet akademike dhe ato infrastrukturore. Këto standarde verifikohen dhe çertifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Neni 53

Ciklet dhe programet e studimeve

1. UPT ofron programe studimi të akredituara të studimeve universitare, të organzuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS).
2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite. Një kredit i korespondojnë 25 orë mësimore punë për studentin. Gjatë një viti, orët për punë të pavarur të studentit zenë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm prej 1500 orë mësimore punë të tij, që përfshijnë orët në auditor dhe ato për punë të pavarur.
3. Programet e studimeve, të ofruara nga UPT, janë të organzuara dhe grupuara në kode, që identifikojnë fusha të ngjashme studimi në nivel kombëtar, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Përbajtja e atyre programeve të studimit të UPT që ofrohen edhe nga



disa institucionale të tjera të arsimit të lartë, në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë kanë një ngjashmëri në nivel së paku 70 për qind.

4. Programet e studimeve në UPT organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
5. UPT mund të ofrojë programe me karakter profesional të lartë, me kohëzgjatje 1 ose 2 vjeçare, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në ato fushat inxhinierike, ku plotësohen kriteret dhe standartet shtetërore, në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri.
6. UPT ofron programe të formimit të vazhduar, në ato fushat inxhinierike, ku plotësohen kriteret dhe standartet shtetërore, sipas nevojave të tregut të punës.
7. Programet e studimeve hartohen nga njësitat bazë të UPT dhe miratohen në SAUPT, pasi kanë kaluar në procesin e vlerësimit të cilësisë së hartimit/riorganizimit të kurrikulës në, në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë, misionit dhe strategjisë së UPT.
8. Elementët që përbajnë programet e studimit, të ofruara nga UPT janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kriteret, standartet, elementët e hollësishëm të programeve të studimit dhe procedura për hartimin dhe riorganizimin e tyre miratohen në SAUPT dhe janë pjesë e rregullores së UPT.
9. UPT shpall publikisht në faqen e tij zyrtare të Internetit dhe në portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

Neni 54
Programet e studimit me karakter profesional

1. Programet e studimit me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me 60 ose 120 kredite formimi. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer.
2. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të transferimit të studimeve, të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të UPT.

Neni 55
Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS). Kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike dhe në përfundim lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.



- Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në rregulloret e programeve të studimit të ciklit të parë përcaktohen mënyra e diplomimit, kriteret dhe procedura e diplomimit.

Neni 56
Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. UPT ofron programe të ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si më poshtë vijon:
 - a) Programe studimit "Master i shkencave", të cilat pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Në UPT, këto programe organizohen në dy forma:
 - programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
 - programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 kredite dhe me kohëzgjatje normale pesë vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e arkitekturës dhe urbanistikës.
 - b) Programet e studimeve "Master profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.
2. Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.
3. Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master Profesional" në fushën e arsimimit të kryer. Pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të programit të studimeve "Master profesional" të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.


Neni 57
Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve në UPT përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata si dhe studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Programet e studimeve "Master ekzekutiv" ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimimit të kryer.

3. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional në fushat inxhinjerike që hapen në përputhje me kërkesat e tregut të punës e që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi" në fushën përkatëse të programit të studimit.
4. Programet e studimit të doktoratës ofrohen në të gjitha fushat inxhinjerike që mbulon UPT.
5. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur tëkandidatëve në kërkimin shkencor në fushat epërcaktuara nga Departamentet ose Fakultetet e UPT. Atokanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritëkrijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor". Kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor përcaktohen në rregulloren e programit të studimit të doktoratës.
6. Elementët që përbajnjë programet e studimit të ciklit të tretë në UPT, kriteret, standartet dhe procedurat e hartimit/riorganizimit të tyre bëhen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, miratohen në SAUPT dhe janë pjesë e rregullores së UPT.
7. Organizimi i këtyre programeve dhe kontrolli i cilësisë së tyre përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve.

Neni 58
Programet e përbashkëta të studimit

1. Njësitë kryesore të UPT, mund realizojnë programe të përbashkëta studimi të ciklit të pare, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.
2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta mund të kryhet në UPT ose në një apo në disainstitucionale pjesëmarrëse, në përputhje memarrëveshjen e bashkëpunimit.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga UPT dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse.
4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucionet e huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
5. UPT mund të organizojë me institucionet e huaja të arsimit të lartë formime të delokalizuara, mbi bazën e një marrëveshjeje "ad-hoc", e cila miratohet nga SAUPT dhe BAUPT.



Neni 59
Studimet e doktoratës

1. UPT ofron studime të doktoratës në bazë të projekteve kërkimore shkencore dhe të zhvillimit të njësive bazë dhe kryesore të UPT.
2. UPT përcakton në rregulloren e tij, me miratimin e BAUPT, mbulimin finansiar të programit të doktoratave, që realizohen nga njësitat bazë ose kryesore të tij.
3. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, doktoranti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera publike / private apo të vetëfinancohet.
4. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësive bazë të UPT, ose me kohë të zgjatur, në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit shkencor bazë ose të zbatuar.
5. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në UPT në bashkëpunim me një institucion tjetër të arsimit të lartë, atëherë pjesë të procesit kërkimor mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
6. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asocuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njejtën kohë.
7. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekt kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.
8. Numri i doktorantëve, që udhëheq në të njejtën kohë personeli akademik i UPT i kategorisë “Profesor”, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, ku ai është i angazhuar, përcaktohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kornizën ligjore në fuqi.
9. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, SHBA dhe Kanada, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të ketë gradën shkencore “Doktor”.

Neni 60
Programet e studimeve të formimit të vazduar

1. UPT ofron programe të studimeve të formimit të vazduar, si formë e të mësuarit për gjatë gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njojurive dhe ofrohen si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimitari të ngjashme. Ato shërbejnë për të rritur kualifikimin dhe aftësitë profesionale të individëve.
2. Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre, përcaktohen në mënyrë të pavarur nga njësitat bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me ministritë e linjës, nëse kanë kompetencë, sipas kornizës ligjore për profesionet e rregulluara, miratohen në SAUPT dhe bëhen publike nga njësitat kryesore respektive.



3. Në përfundim të këtyre programeve, individeve të kualifikuar u lëshohet Çertifikata përkatëse, firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i UPT-së. Për të fituar një Çertifikatë në përfundim të një programi formimi të vazhduar, studenti duhet të ketë grumbulluar një numër të nevojshëm kreditesh. Këto përcaktohen nga SAUPT, mbi bazën e propozimit të njësisë bazë përkatëse. Çertifikatat e lëshuara regjistrohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
4. Njësitë kryesore të UPT mund të ofrojnë edhe kurse përgatitore për programet e studimeve që organizojnë.

Neni 61
Pranimet në programet e studimit të UPT

1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin/kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Njësia bazë përgjegjëse mund të vendosë kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat propozohen nga njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe miratohen në Senatin Akademik.
2. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar të paktën një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga departamentet dhe miratuar në senatin akademik të UPT.
3. UPT mund të njoftë kredite të përsituara në programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i shkencave", duke respektuar procedurat dhe kërkesat e rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies si edhe kornizës ligjore në fuqi.
4. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Masteri shkencave", ose diplomë tjeter të njëvlershme me të dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga njësitë bazë, në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë dhe të miratuar nga SAUPT.
5. Kriteret bëhen publike në faqen e internetit të UPT dhe i vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
6. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" dhe të ciklit të tretë është njoftja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Niveli i njoftjes së gjuhës së huaj miratohet nga SAUPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.



7. Në fillim të vitit akademik, UPT dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar në të gjitha programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve.
8. Lista e të diplomuarve në programet e studimeve të ciklit të tretë përcillet nga UPT në ministrinë përgjegjëse për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

Neni 62
Transferimi i studimeve
Njohja dhe njësimi i periudhave të studimit

1. UPT ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtat cikël studimi, brenda UPT apo nga institucionë të ndryshme të arsimit të lartësia brenda ashtu edhe jashtë vendit. Periudha e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucionë të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen nga UPT.
2. Transferimet bëhen brenda të njëjtat cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përaferta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. UPT ofron mundësinë e transferimit të studimeve nga programe të sistemeve të mëparshme të studimeve universitare në UPT në programe të ciklit të parë ose të dytë të studimeve. Departamentet dhe fakultetet përcaktojnë fushat e përaferta të studimit që lejohen për transferimin e studimeve për programet e studimit që kanë nën përgjegjësi.
3. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e studimeve, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në institucionin pritës të arsimit të lartë, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga departamenti ose fakulteti i UPT.

Neni 63
Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Në UPT, çdo individ, që ka përfunduar një program studimi, ka të drejtë të ndjekë një program të dytë studimi të të njëjtat cikël. Në këtë rast, kandidati përballon koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përashtohen studentët e shkëlqyer.
2. Kriteret bazë dhe procedurat për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloren e studimeve të UPT. Njësitet bazë, përgjegjëse për programin e studimit, mund të përcaktojnë kriterë të tjera specifike, të cilat duhet të miratohen nga Senati Akademik i UPT.



Neni 64

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në UPT zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin.
2. Viti akademik organizohet në 2 semestra. Semestri ka të paktën 14 javë mësim. Ngarkesa javore në auditor është të paktën 20 orë mësimi leksione, seminare/ushtrime, laboratorë me strukturë të pasqyruar në programet e studimeve përkatëse. Organizimi i mësimdhënjes, sezonit të provimeve, sezonit të mbrojtjes së diplomave shpallet në strukturën mësimore, e cila miratohet nga Rektori. Organizimi i procesit mësimor për çdo program studimi shprehet në orarin mësimor, i cili shpallet nga dekanati i Fakultetit.
3. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimit tarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar, e cila përcaktohet në rregulloren e studimeve në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
4. Organizimi i mësimdhënies në rastin e diplomave të përbashkëta të UPT me institucione të huaja të arsimit të lartë realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që përcaktojnë veprimit tarive mësimdhënëse institucioneve të përfshira në këto studime.

Neni 65


Gjuha e studimeve

1. Programet e studimit në UPT ofrohen normalisht në gjuhën shqipe. Në raste të veçanta si dhe në rastin specifik të programeve të përbashkëta të studimit ose të delokalizuara, të ofruara me institucione të huaja të arsimit të lartë, gjuha e përdorur mund të jetë edhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit European, të miratuar në aktin e hapjes së programit të studimit.
2. Në rastin e programeve të studimit që ofrohen në gjuhë të huaj, studentët duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm, të përcaktuar nga SAUPT në marreveshje me institucionet e huaja të arsimit të lartë.

Neni 66

Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
2. Për të gjithë ata studentë, që nuk arrijnë të përfundojnë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, UPT u krijon mundësinë që të aplikojnë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjeter të UPT. Studenti i nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrim në programin përkatës të studimit. UPT ofron mundësinë e njohjes dhe transferimit të krediteve të grumbulluara nga studenti



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

gjatë periudhës së mëparshme të studimeve. Njohja dhe transferimi i studimeve bëhet me vendim të departamentit/fakultetit, që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e studimeve.

Neni 67

Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës

1. Në përfundim të programit të studimit, UPT e pajis studentin me diplomën ose certifikatën përkatëse. SAUPT miraton formën, elementët përbërës dhe modelin e diplomave dhe certifikatave që lëshohen, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato "Master ekzekutiv" të ciklit të tretë shoqërohen me suplementin e diplomës.
3. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpala se të lëshohet nga UPT, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
4. UPT nuk lëshon dublikatë diplome, por mund të lëshojë "Vërtetim Diplome", dokument të barasvlershëm me diplomën, i cili përmban të njejtët element identifikues që ka diploma.
5. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në rregulloren e studimeve, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.



KREU VIII


ORGANIZIMI I KËRKIMIT SHKENCOR, GRADAT SHKENCORE DHE TITUJT AKADEMIKE NE UPT

KËRKIMI SHKENCOR NE UPT

Kërkimi shkencor në UPT mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit dhe gërshtohet me mësimdhënien me pikësynim rritjen e cilësisë së ofertës akademike.


Neni 68 Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në UPT

1. Veprimtaritë kërkimore dhe të zhvillimit në UPT lidhen me:
 - a) punën krijuese të ndërmarrë mbi një bazë sistematike pranë njësive bazë të UPT në mënyrë që të rritet bagazhi i dijeve;
 - b) pjesëmarrjen në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferanca, seminare, kongrese,ëorkshop-e, etj;
 - c) publikimin e monografive dhe artikujve në periodikë apo seri botimesh shkencore me bord vlerësues dhe drejtues;
 - d) pjesëmarrjen në borde revishtash shkencore;dh) udhëheqjen e doktoratave.
2. Kërkimi shkencor në UPT është bazë dhe i zbatuar, veprimtari me interes të gjërë publik, që ndermerret për të përbushur misionin e njësive bazë të tij, sipas standardeve bashkëkohore.
3. Kërkimi shkencor bazë nënkupton studime të mirëfillta, plotësuese dhe saktësime të mëtejshme, për probleme ende të pazgjadhura, në fushat e veprimtarisë të njësive bazë, të cilat synojnë të arrijnë ritmet e zhvillimit teorik bashkëkohor brenda dhe jashtë vendit.
4. Kërkimi shkencor i zbatuar është veprimtari kërkimore-shkencore që synon zgjidhje praktike e specifike dhe që shoqërohet me rinnovime teknologjike bashkëkohore në formë analitike, të vrojtimeve monitoruese, të përpunimit të informacionit etj., për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e tyre.
5. Arritjet në kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar rrisin shkallën e kualifikimit të personelit akademik dhe krijojnë burime materiale për zhvillimin e mëtejshëm të tij.
6. Arritjet në kërkimin shkencor, nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore, të metodave, metodikave të kërkimit si edhe të teknologjive bashkëkohore,i përditësojnë ato në mënyre të vazhdueshme me njohuri shkencore dhe praktika të avancuara.



Neni 69
Struktura kërkimore-shkencore në UPT

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore në UPT zhvillohet në:
 - a) njësitë bazë të Fakulteteve;
 - b) njësitë bazë të Institutit të Kërkim Zhvillimit.
2. Njësitë bazë të Fakultetit dhe të Institutit të Kërkim Zhvillimit në UPT:
 - a) zhvillojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me misionin dhe fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si edhe me programet e zhvillimit në rang rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - b) u nënshtronen kritereve të financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të përcaktuara në këtë statut dhe në kornizën ligjore në fuqi;
 - c) kanë detyrimin të bëjnë publike veprimtarinë e tyre, si dhe rezultatet përkatëse, me përjashtim të rasteve të veçanta, që rregullohen në kornizën ligjore.
3. Njësitë bazë në UPT kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuar nepermjet projekteve kërkimore shkencore kombetare dhe nderkombetare dhe veprimtarive të tjera krijuese të përcaktuara në kete statut, sipas natyrës dhe objektivave specifikë të tij dhe ne kornizen ligjore ne fuqi.
4. Veprimtaria kërkimore-shkencore që kryhet ne UPT synon të rrisë cilësinë e arsimimit, nepermjet integrimit te saj me mësimdhënien.
5. Personeli akademik dhe studentët, nëpërmjet veprimtarise kërkimore-shkencore, fitojnë aftësi metodologjike për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qendrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.
6. Veprimtaria kërkimore-shkencore e krijuese rregullohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, si edhe me këtë statut.
7. Veprimtaria kërkimore-shkencore ne UPT realizohet mbi bazën e programeve dhe projekteve te miratuara dhe realizuara në njësitë bazë, njësitë kryesore dhe struktura ndërdisiplinore.
8. Fushat kërkimore dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë kërkimore përcaktohen nga SAUPT në planin strategjik të UPT mbi bazën e propozimeve të njësive bazë dhe kryesore të tij.
9. UPT harton/realizon programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim institucionale të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.
10. UPT ofron nëpërmjet veprimtarive kërkimore shkencore, të zhvillimit dhe krijuese sherbime për të tretët. Të ardhurat e krijuara nga këto veprimtari administrohen nga njësia bazë ose ajo kryesore, që realizon veprimtarinë dhe ndahen ndërmjet personelit akademik e UPT që kryen veprimtarinë, sipas rregullores së miratuar nga BAUPT.
11. Njësitë bazë të UPT, brenda muajit të parë të çdo viti kaledarik, hartojnë raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore-shkencore të kryer.



Neni 70

Planifikimi dhe financimi i veprimtarive kërkimore-shkencore

1. Njësitë kryesore të UPT, mbështetur në kërkesat e njësive bazë, hartojnë planin afat-mesëm të zhvillimit të tyre, mbi bazën e të cilit hartohen programet vjetore duke percaktuar e vendosur raporte të drejta ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me misionin, që ato kanë.
2. Veprimtaritë e kërkimit shkencor në UPT mbështeten në planin buxhetor afat-mesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të UPT përditësohen çdo vit.
3. Veprimtaritë e kërkimit shkencor në UPT financohen nga buxheti i shtetit, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, dhe financimeve të tjera të ligjshme nga ente/subjekte publikë ose privatë.
4. Kërkesa për financimin e programit vjetor të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar nga buxheti i shtetit bëhet nga njësitë bazë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe rregulloren e UPT.
5. Njësitë bazë të UPT brenda muajit tetor të çdo viti, dorëzojnë në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor planin e veprimtarise kërkimore-shkencore të vitit pasardhës.

Neni 71

Projektet kërkimore-shkencore

1. Forma kryesore e realizimit të veprimtarisë të kërkimit shkencor është projekti.
2. Personeli akademik i UPT, në përputhje me fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit si edhe me programet e zhvillimit të vendit, janë të lirë të grupohen e të hartojnë projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare:
 - a) brenda dhe jashtë njësive bazë të UPT;
 - b) në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit;
 - c) të ndjekin procedurat ligjore për shqyrtimin e miratimin e tyre dhe të vihen në dispozicion të zbatimit të tyre me cilësine e kërkuar.
3. Drejtuesit e njësive kryesore në bashkëpunim me Rektoratin e UPT marrin masa administrative për hartimin dhe realizimin në kohë të detyrave të parashikuara në planin e punës të kërkimit shkencor dhe të financimit të projektit të miratuar, në përputhje me objektivat e zhvillimit, objektivat dhe rezultatet e priteshme te tyre.
4. Procedurat e hartimit dhe realizimit të projekteve kërkimore-shkencore në UPT përcaktohet ne rregulloren e tij.

Neni 72
Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

1. UPT vendos kritere për vlerësimin vjetor të ecurisë së personelit akademik të tij dhe vijimin e veprimtarisë kërkimore.
2. Veprimtaria kërkimore-shkencore e personelit akademik në UPT vlerësohet sipas përcaktimeve në kornizën ligjore në fuqi dhe rregulloren e UPT.

Neni 73
Baza e të dhënave për kërkim shkencor në UPT

1. Të dhënat e kërkimit shkencor për UPT mblidhen si shënimë stastistikore të standartizuara dhe ruhen në një bazë të dhënash "ad hoc".
2. Baza e të dhënave për kërkimin shkencor në UPT administrohet dhe përditësohet nga Drejtoria e Kërkimit Shkencor të UPT, në të cilën përfshihen:
 - a) lista e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga të pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;
 - b) lista e punimeve të diplomave të ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga të pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;
 - c) lista e përditësuar të kërkimit shkencor të personelit akademik e kërkimor të fakulteteve dhe të Institutit të Kërkim Zhvillimit.
3. Baza e të dhënave e të gjithë projekteve të finançuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim zhvillimit, administrohet dhe bëhet publike nga UPT.

GRADAT SHKENCORE DHE TITUJT AKADEMIKE

Misioni i UPT është të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të mirëqënies dhe të demokracisë në Republikën e Shqipërisë, edhe nëpërmjet dhënieve së gradës shkencore "Doktor" dhe të titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Neni 74


Pranimi në programin e studimeve të doktoratës

1. Pranimi në programin e studimeve të doktoratës është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Master i Shkencave” ose të barazvlefshme me të dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara në rregulloren e UPT.
2. Kriteret e pranimit dhe regjistrimi në programet e studimeve të doktoratës përcaktohen nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, kornizën ligjore në fuqi dhe ato bëhen publike nga UPT.
3. Kriteri pranimi në programin e studimit të doktoratës është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkontaktuale në nivelin e përcaktuar nga kornizaligjore në fuqi.
4. Diploma e fituar nga Kandidati në një program studimi të kryer në një nga këto gjuhë, shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të pranimit në programin e studimit të doktoratës.
5. Studimet e doktoratës kryhen në përputhje me nenin 61 të këtij statuti.

Neni 75

Kriteret e fitimit të gradës shkencore “Doktor” në UPT

1. Kriteret minimale, që duhet të përbushë kandidati për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, janë në përputhje me përcaktimet e kornizës ligjore në fuqi.
2. UPT përcakton kriteret specifike shtesë, që duhet të plotësojë kandidati në Rregulloren e tij
 - a) për aplikimin, në funksion të fushës së kërkimit;
 - b) gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, për çdo vit akademik;
 - c) përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së doktoratës.
3. Kandidati paraqet në format të shtypur dhe elektronik tezën e doktoratës, të miratuar nga udhëheqësi shkencor, dhe e depoziton atë në njësinë bazë përkatëse të UPT në gjuhën shqipe dhe një përbledhje e sajnë një prej gjuhëve të BE: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, sipas formatit të përcaktuar në Rregulloren e UPT (apo njësisë kryesore).
4. Grada shkencore “Doktor”, fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së doktoratës në përfundim të studimeve të saj, brenda afateve të përcaktuara në kornizën ligjore në fuqi.
5. Njësia bazë ose njësia kryesore, përcakton nëpërmjet rregullores përkatëse për programin e doktoratës, rastet kur studimet për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, ndërpriten, shtyhen ose pezullohen sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
6. Procedurat e fitimit të gradës shkencore “Doktor” përcaktohet në Rregulloren e UPT.




Neni 76
Titujt akademikë

1. UPT jep titujt akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asocuar".
2. Standartet shtetërore minimale për fitimin e titujve akademike "Profesor" dhe "Profesor i asocuar", percaktohen në kornizën ligjore në fuqi.
3. Standartet specifike shtesë për fitimin e titujve akademike "Profesor" dhe "Profesor i asocuar", percaktohen në Rregulloren e UPT.

Neni 77
Fitimi i titujve akademikë në UPT

1. Për fitimin e titullit "Profesor i Asociuar" në UPT mund të aplikojë personeli akademik, që zotëron prej së paku pesë vitesh gradën shkencore "Doktor" dhe është personel akademik i kategorisë "Lektor", si dhe përbush standartet shtetërore për fitimin e tij.
2. Për fitimin e titullit "Profesor" në UPT mund të aplikojë personeli akademik, që zotëron prej së paku pesë vitesh titullin akademik "Profesor i Asociuar", si edhe përbush standartet shtetërore për fitimin e tij.
3. Kandidati për fitimin e titullit "Profesor i asocuar" ose "Profesor" paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet SAUPT, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. SAUPT i kalon dosjen Komisionit të Përherëshëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përbushjen e standardeve.
4. Procedurat për fitimin e titujve "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" percaktohen në Rregulloren e UPT.
5. Titulli akademik, që lëshohet nga UPT firmoset nga Rektori i tij.



KREU IX

SIGURIMI I CILËSISË

Neni 78


Organizimi strukturor i sigurimit të cilësisë në UPT

1. UPT është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë (më poshtë sigurimi i cilësisë) në të gjitha njësítë përbërëse organizative. Për këtë, funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standarde tħall teorit, dhermet evropiane pér sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane tē Arsimit tē Lartë.
2. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe Njësítë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore tē UPT.
3. NJQSC harton standarde institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Këto standarde miratohen nga SAUPT.
4. NJQSC i propozon Rektoratit tē UPT, projektbuxhetin e nevojshëm pér ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë. Këto fonde parashikojnë funksionimin e Rrjetit të Cilësisë, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm, trajnime, konsulencë dhe ekspertizë tē jashtme, publikime, veprimitari informuese dhe promovuese, projekte pilot, krijim dhe përditësim të sistemeve elektronike tē ruajtjes dhe menaxhimit tē dhënavë, pajisjen me logistikë dhe çdo element tjetër tē parashikuar në rregulloren e Sigurimit të Cilësisë.

Neni 79

Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC)

1. Përbërja e NJQSC propozohet nga SAUPT dhe miratohet nga BAUPT.
2. Drejtuesi i NJQSC varet drejtpërsëdrejti nga Rektori i UPT.
3. NJQSC mund tē angazhojë periodikisht ekspertë tē jashtëm pér çështje specifike ose/edhe specialistë tē nivelit tē lartë tē fushës së sigurimit të cilësisë sipas nevojës pér konsulencë, ekspertizë ose pér çështje tē tjera.
4. NJQSC gëzon autonomi në punën e saj dhe ka akses në të gjitha tē dhënat e institucionit.
5. NJQSC kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) koordinon veprimitarinë e sigurimit të cilësisë me çdo aktor në UPT;
 - b) harton rregulloret dhe dokumentacionin e nevojshëm në kuadër tē menaxhimit të cilësisë nga njësítë përbërëse;



- c) kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore-shkencore, si dhe të aspekteve të tjera të lidhura me to;
- d) realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga UPT;
- e) planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit si edhe të vlerësimit të brendshëm institucional;
- f) në fund të çdo semestri organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies përlindët e çdo programi studimi;
- g) raporton drejtperdrejtë te Rektori i UPT, permes rezultateve të vlerësimit te brendshem ne nivel njesie dhe/ose programi studimi, si dhe ndjek implemetimin e rekomandimeve te evidentuara;
- h) harton raportin vjetor të cilësisë në UPT;
- i) mban lidhje të vazhdueshme me ASCAL dhe institucionet e tjera të cilësisë, për shkëmbimin e të dhënavëve dhe raportimin në kuadër të vlerësimit të jashtëm të cilësisë;
- j) vlerëson kostot e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për të tria ciklet e programeve të studimit dhe ia përcjell bordit të administrimit;
- k) propozon buxhetin e nevojshëm për funksionimin e saj.


Neni 80
Njësitë e Sigurimit të Cilësisë

1. NJSC ngrihen në njësinë kryesore dhe mbulojnë, për sa i përket sigurimit të cilësisë, çdo program studimi dhe kërkimin-shkencor, që njësitë bazë të asaj njësie kryesore e ofrojnë/kryejnë. Numri i anëtarëve të NJSC propozohet nga SAUPT për çdo njësi kryesore të UPT dhe miratohet nga BAUPT.
2. Anëtarët e NJSC, zgjidhen në përputhje me rregulloren e Sigurimit të Cilësisë.
3. NJSC në njësinë kryesore kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) koordinon veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore duke u shtrirë në çdo program studimi dhe kërkimi-shkencor të ofruar;
 - b) planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit në njësinë kryesore;
 - c) në bashkëpunim me Dekanatin / Drëktorinë e njësisë kryesore, harton planin vjetor të veprimit përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë;
 - d) mban lidhje të vazhdueshme me NJQSC për zhvillimin e proceseve të parashikuara në kornizën ligjore në fuqi si dhe në rregulloret dhe procedurat e UPT.

Neni 81

Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit dhe kërkimit-shkencor

1. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit dhe kërkimit-shkencor apo institucional realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL dhe organizohet si rregull një herë në tre vjet. Nëse është e nevojshme, mund të organizohen vlerësime të pjesshme apo të plota edhe më shpesh. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitet dhe mënyra e paraqijes së rezultateve përcaktohen në rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe procedurat përkatëse.
2. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit-shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizimat studentore. Në rast nevoje, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nga Dekanati /Drejtoria e njësisë kryesore që mbulon programin e studimit dhe kërkimit-shkencor në bashkëpunim me NJSC apo nga Rektorati në bashkëpunim me NJQSC në rastin e vlerësimit të brendshëm institucional. Grupi i vlerësimit të brendshëm gëzon autonomi funksionale dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
3. Përfundimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënavë, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuar me stafin akademik, stafin joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionin. Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike.
4. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë dhe akreditimi kryhen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
5. Njësia kryesore ka përgjegjësinë e sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për mbulimin e gjithë veprimtarisë së procesit së vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm. Në rastin e vlerësimit institucional, këto burime sigurohen nga Rektorati.



KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 82

Studentët dhe titujt universitarë

1. Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të kornizës aktualeligjore të arsimit të lartë, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij, në përputhje me kornizën ligjore të arsimit të lartë në fuqi në kohën e tyre të regjistrimit, nëse ai program studimi ofrohet ende nga njësitë akademike të UPT. Nëse ai program studimi nuk ofrohet më, njësia bazë/kryesore përgjegjëse e atij programi studimi organizon për ata studentë një program studimi "ad hoc".
2. Për studentët, që nuk arrijnë të përfundojnë studimet në periudhën normale të studimevenë përputhje me kornizën ligjore të arsimit të lartë në fuqi në kohën e tyre të regjistrimit, afati i fundit i përfundimit të tyre përcaktohet nga SAUPT me propozim të njësisë bazë/kryesore përgjegjëse të programit të studimit.

Neni 83


Personeli akademik

1. Personeli akademik i punësuar në UPT, i cili nuk ka shkallën e kërkuar tëkualifikimit sipas vendit të punës, duhet që brenda dy viteve, na hyrja në fuqi e këtij statuti, të kryejë kualifikimet e kërkuaara ose të largohet nga vendi i punës. UPT krijon kushtet dhe mundësitet për kualifikimet e nevojshme.
2. Personeli akademik, i cili ka paraqitur kërkesën për fitimin e titullit akademik para hyrjes në fuqi të kornizës aktuale ligjore të arsimit të lartë, do të vazhdojë procedurat e fitimit të titullit akademik të kërkuar prej tij dhe në përputhje me kornizën ligjore të arsimit të lartë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës së tij, vetëm përsa i përket standardave të fitimit të titullit në fjalë.

Neni 84

Rregulloret e UPT dhe njësive të tij

1. Në zbatim të këtij Statuti hartohet, Rregullorja e UPT, e cila përfshin në krerë të veçantë:
 - Rregulloren e funksionimit të SAUPT, miratuar nga SAUPT;
 - Rregulloren e funksionimit të BAUPT, miratuar nga BAUPT;
 - Rregulloren e Rektoratit, miratuar nga Rektorati i UPT;



Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës

- Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, miratuar nga SAUPT;
 - Rregulloren e kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT, miratuar nga SAUPT;
 - Rregullorja e Komisionit të Perhershëm të Promovimit të Tituve Akademikë, miratuar nga SAUPT;;
 - Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë, miratuar nga SAUPT;;
 - Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Etikës, miratuar nga Këshilli i Etikës;
 - Kodi i etikës së UPT, miratuar nga SAUPT;
 - Rregulloren e brendshme për administrimin, finaneat dhe kontabilitetin, miratuar nga BAUPT.
2. Në zbatim të këtij Statuti hartohen gjithashtu:
- Rregulloret e njësive kryesore, miratuar nga Asambleja e Personelit akademik të njësisë kryesore përkatëse;
 - Rregullorja e Këshillit të Profesorëve të njësive kryesore, miratuar nga Asambleja e Personelit akademik të njësisë kryesore përkatëse;
 - Rregulloret e njësive bazë, miratuar nga personeli akademik i njësisë bazë përkatëse.

Neni 85 Vulat në UPT

1. Universiteti Politeknik i Tiranës ka vulën e tij zyrtare, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. Njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UPT kanë vulën e tyre, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
3. UPT ka faqen e tij zyrtare të internetit me adresë www.upt.al, e cila administrohet nga UPT ose nga një entitet tjeter, i autorizuar prej tij.

Neni 86 Hyrja në fuqi

1. Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës hyn në fuqi më datë _____

